



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR
KRITERET E LICENCIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË BURSIVE DHE
OPERATORËVE TË TREGUT QË VËNË NË FUNKSION VEPRIMTARINË
E NJË TREGU TË RREGULLUAR**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 89, datë 31.05.2023
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 119, datë 25.07.2025*

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

1. Përcaktimi i kërkesave për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë të operatorit të tregut që vë në funksion një treg të rregulluar;
2. Përcaktimi i kërkesave për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Bursës.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore është hartuar në bazë dhe për zbatim të neneve, 147, pika 1, 154, pika 3 dhe pika 8, neni 172, dhe neni 285, pika 3 të ligjit nr. 62/2020, “Për tregjet e kapitalit”, i referuar këtu e në vijim si “Ligji”.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga operatorët e tregut që vënë në funksion veprimtarinë e një tregu të rregulluar, duke përfshirë Bursat, si dhe anëtarët apo pjesëmarrësit e këtyre operatoreve.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Aplikant”** është subjekti që aplikon pranë Autoritetit për licencë për të operuar një Bursë ose treg të rregulluar.
2. **“Të dhënat e tregut”** janë:
 - a) çmimet aktuale të blerjes dhe shitjes dhe interesave të tregtimit në ato çmime që reklamohen nëpërmjet sistemeve për instrumentat financiare që tregtohen në një treg të rregulluar;
 - b) çmimi, vëllimi, madhësia, koha e transaksioneve që ekzekutohen në lidhje me instrumentat financiare që tregtohen në tregun e rregulluar;
 - c) Ose çdo e dhënë tjetër që ofrohet nga operatori i tregut dhe/ose bursa.
3. **“Heqje dorë nga transaksioni”(give up)** ose **“Dorëzimi i transaksionit” (give in)** është kalimi ose marrja e transaksionit/tregtimit për llogari të klientit nga një shoqëri komisionere në një shoqëri tjetër në raste të caktuara për qëllime të ekzekutimit të transaksionit.
4. Të gjitha përkufizimet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligj.

KREU II

PROCEDURA PËR LICENCIMIN E BURSËS DHE OPERATORIT TË TREGUT QË VË NË FUNKSION NJË TREG TË RREGULLUAR

Neni 5

Ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë pa licencë

1. Asnjë person nuk mund të krijojë ose të operojë një bursë, të asistojë në krijimin ose operimin ose të pretendojë se ofron apo operon një bursë, nëse ky person nuk është i licencuar nga Autoriteti.
2. Kërkesat e pikës 1, të këtij neni zbatohen edhe për operatorin e tregut që synon të vërë në funksion një treg të rregulluar.

Neni 6

Dokumentacioni i kërkuar për licencim

1. Subjekti kërkuar që paraqet kërkesën për licencim të veprimtarisë së bursës apo një operatori tregu që vë në funksion veprimtarinë e një tregu të rregulluar duhet t'i sigurojë Autoritetit dokumentacion dhe informacion në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga neni 7 deri në nenin 9 dhe neni 22 të kësaj rregulloreje, si dhe neni 147 të Ligjit.
2. Nëse subjekti kërkuar që paraqet kërkesën për licencim të veprimtarisë së bursës apo një operatori tregu që vë në funksion veprimtarinë e një tregu të rregulluar, përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, duhet t'i provojë Autoritetit, duke ofruar dokumentacion dhe informacione përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara nga neni 142 në nenin 144 të Ligjit, si dhe përputhshmërinë me kriteret për kapital, të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregulloreje, si dhe kriteret për raportim, të përcaktuara në nenin 19 të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Përmbajtja e aplikimit

1. Subjekti kërkuar që kërkon të pajiset me licencë për të vepruar si bursë/operator tregu që vë në funksion një treg të rregulluar paraqet pranë Autoritetit aplikimin së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Të dhënat e personit përgjegjës për aplikimin;
 - b) Aktin e themelimit, statutin, ku objekti i veprimtarisë, të përputhet me veprimtarinë për të cilat subjekti kërkon të licencohet si dhe të përshkruhet roli i anëtarëve të Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës, shoqëruar me një përshkrim të detyrave dhe përgjegjësisive të tyre ose dokumentacion tjetër rregullues ekuivalent;
 - c) Ekstraktin e regjistrimit në QKB të subjektit kërkuar;
 - d) Vendimin e Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës për ushtrimin e veprimtarisë si bursë/operator tregu që vë në funksion një treg të rregulluar;
 - e) Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:
 - (i) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;
 - (ii) Të dhënat e parashikuara në shkronjën (i), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.
 - f) Masat dhe procedurat që sigurojnë përputhshmërinë me detyrimet e parashikuara në këtë rregullore;
 - g) Rregulla/procedura të subjektit kërkuar të cilat përmbajnë përcaktime të përshtatshme për sa më poshtë:
 - (i) për të siguruar që subjekti kërkuar, për aq sa është e realizueshme në mënyrë të arsyeshme, do të operojë një treg të rregullt dhe të drejtë në lidhje me instrumentet që tregtohen nëpërmjet shërbimeve të tij;
 - (ii) për të siguruar që subjekti kërkuar do të administrojë me kujdes çdo rrezik që lidhet me veprimtarinë dhe operacionet e tij;

- (iii) për të siguruar që subjekti kërkues, në përmbushje të detyrimeve në bazë të shkronjës a) të kësaj pike, nuk do të veprojë në kundërshtim me interesin publik dhe në veçanti me interesin e investitorëve;
- (iv) për të siguruar që subjekti kërkues do të mund të ndërmarrë veprimet e duhura ndaj anëtarëve pjesëmarrës, të cilët janë objekt i rregulloreve;
- (v) për të siguruar që rregulloret e miratuara nga subjekti kërkues do të jenë transparente dhe jodiskrecionale dhe do të përmbajnë përcaktime të mjaftueshme për:
 - (a) pranimin e pjesëmarrësve në tregtim;
 - (b) rregullimin dhe mbikëqyrjen e duhur të anëtarëve;
 - (c) përjashtimin e anëtarëve që nuk përmbushin kriterin e aftësisë dhe përshtatshmërisë;
 - (d) përjashtimin, pezullimin ose disiplinimin e anëtarëve, përfshirë vendosjen e gjobave ndaj tyre;
 - (e) rregullat e listimit në lidhje me kushtet me të cilat mund të listohen ose të ofrohen për tregtim klasat e titujve në tregun që propozon të zhvillojë subjekti kërkues;
 - (f) kushtet që rregullojnë tregtimin e titujve nga anëtarët;
 - (g) ndalimin e abuzimit të tregut, sjelljeve të parregullta ose tregtimin bazuar në informacion të privilegjuar;
 - (h) pezullimin dhe heqjen e instrumenteve financiare nga tregtimi në një treg të rregulluar, në funksion të mbrojtjes së investitorëve, ruajtjes së një tregu të rregullt dhe të drejtë ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme;
 - (i) emërimin e një komiteti disiplinor;
 - (j) lidhjen e kontratave midis subjektit kërkues dhe anëtarëve, sipas të cilave anëtarët bien dakord të zbatojnë rregullat e subjektit kërkues;
 - (k) në përgjithësi, kryerjen e veprimtarisë së subjektit kërkues, duke i kushtuar rëndësinë e duhur mbrojtjes së investitorëve dhe interesit publik;
- (vi) për të siguruar një metodë të shpejtë dhe të drejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve:
 - (a) midis bursës/operatorit të tregut dhe anëtarëve të saj; dhe
 - (b) midis anëtarëve;
- (vii) subjekti kërkues duhet të ketë burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe të tjera për të garantuar:
 - (a) një treg të rregullt dhe të drejtë në lidhje me titujt që tregtohen nëpërmjet shërbimeve të tij;
 - (b) mjedise të përshtatshme dhe të pajisura siç duhet për ushtrimin e veprimtarisë;
 - (c) një personel kompetent për ushtrimin e veprimtarisë;
 - (d) sisteme të automatizuara me kapacitet adekuat, masa sigurie dhe mundësi për t'u bërë ballë situatave të jashtëzakonshme; dhe

- (e) planet dhe mjetet e duhura për rikuperimin e situatës në rast katastrofe;
 - (viii) që dhënia e licencës do të jetë në interes të publikut ose të tregut.
 - (ix) masat dhe procedurat për të siguruar përputhshmërinë me kriteret e pranimit të instrumenteve financiare në mënyrë të vazhdueshme;
 - (x) procedurat për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve të kryera në sistemin e tregtimit;
 - (xi) masat dhe procedurat për të siguruar trajnimin e duhur të organit drejtues dhe funksionarëve kryesorë;
 - (xii) planin e biznesit për një minimum prej tre vjetësh sipas parashikimeve ligjore;
 - (xiii) strukturën e përshtatshme organizative; një përshkrim të mënyrës së organizimit të brendshëm dhe rolin e organeve drejtuese dhe të administratorëve.
 - (xiv) një listë të anëtarëve të Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës të operatorit të tregut me funksionet e tyre dhe një përshkrim të detajuar të integritetit, njohurive, aftësive, përvojës profesionale dhe kohës së nevojshme për të kryer funksionet e tyre.
2. Krahas dokumentacionit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, subjekti kërkues i bashkëngjit aplikimit edhe konfirmimin për pagesën e plotë të kapitalit fillestar të referuar në nenin 18 të kësaj rregulloreje.
 3. Kërkesa për licencim nuk konsiderohet e plotë derisa të përmbushen të gjitha kërkesat sipas ligjit dhe kësaj rregullore.

Neni 8

Dokumentacioni për administratorin, anëtarin e Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës

1. Dokumentacioni mbi administratorin, anëtarin e Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës është si më poshtë:
 - a) Dokument identifikimi (ID/ pasaportë);
 - b) Curriculum Vitae, ku të detajohet përvoja profesionale;
 - c) Diploma, kualifikime, trajnime dhe dokumente të tjera me rëndësi që vërtetojnë arritjet akademike dhe profesionale;
 - d) Dokument i lëshuar nga administrata tatimore për gjendjen e detyrimeve tatimore;
 - e) Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar.
2. Dokumentacion të lëshuar nga organet kompetente, si më poshtë:
 - a) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;

- b) Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;
- c) Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;
- d) Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera.

3. Deklaratë personale se:

- a) Nuk është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera;
- b) Nuk ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;
- c) Nuk është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që Autoriteti e konsideron të papërshtatshme, qoftë e ligjshme ose jo, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person;
- d) Nuk është dënuar për çfarëdo vepër penale ose administrative në lidhje me ofrimin e shërbimeve financiare apo ndonjë akt mashtrimi ose shpërdorimit të fondeve;
- e) Nuk ka qenë subjekt i një vendimi të pafavorshëm në çfarëdo procedure me natyrë disiplinore nga një autoritet rregullator, një organ qeveritar ose agjenci;
- f) Nuk ka qenë subjekt i një konstatimi të pafavorshëm gjyqësor në proceset civile para një gjykate në lidhje me ofrimin e shërbimeve financiare ose të të dhënave, ose mashtrim në menaxhimin e një biznesi;
- g) Nuk ka qenë anëtar i Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës të një shoqërie, licencimi i së cilës është hequr nga një organ rregullator, ndërkohë që kanë qenë të lidhur me shoqërinë të paktën një vit përpara datës së heqjes së licencës;
- h) Nuk i është refuzuar e drejta për të kryer çdo lloj aktiviteti që kërkon regjistrim ose licencim nga një organ rregullator;
- i) Nuk ka qenë anëtar i Këshillit të Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës të një shoqërie që i është nënshtruar një sanksioni nga një organ rregullator ndërkohë që kanë qenë të lidhur me shoqërinë të paktën një vit përpara se të vendosej një sanksion i tillë;
- j) Nuk është gjobitur, pezulluar, skualifikuar ose subjekt i çfarëdo sanksioni tjetër në lidhje me ofrimin e shërbimeve financiare ose shërbimeve të të dhënave nga një qeveri, organ rregullator ose organ profesional;
- k) Nuk është skualifikuar nga roli i drejtorit ose çdo cilësie tjetër menaxheriale, nuk është shkarkuar nga punësimi ose emërimet e tjera në një shoqëri si rezultat i sjelljes ose keqpërdorimit të detyrës.

4. Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Neni 9

Formulari i aplikimit

1. Kërkesa për licencim i paraqitet Autoritetit me shkrim sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën I të kësaj rregulloreje.
2. Kërkesa për licencim shoqërohet me të gjitha informacionet e nevojshme, në bazë të të cilave Autoriteti mund të vlerësojë nëse subjekti kërkues ka marrë në momentin e licencimit të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur kërkesat e parashikuara në këtë rregullore si dhe në ligj.
3. Subjekti kërkues duhet të sigurojë që nëse një kërkesë e Ligjit dhe e kësaj rregulloreje nuk zbatohet/aplikohet për të, ta deklarojë këtë fakt së bashku me një shpjegim;
4. Dokumentacioni i kërkuar sipas kësaj rregulloreje duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose kopje e noterizuar.
5. Kur aplikanti ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë, ai duhet të japë çdo informacion të kërkuar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.
6. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga një autoritet i huaj rregullator, dokumentacioni duhet të legalizohet në njërin nga mënyrat e mëposhtme:
 - a) Konfirmim nga autoriteti i huaj rregullator siç përcaktohet në legjislacionin e atij vendi;
 - b) Përputhje me përcaktimet në aktet ligjore përkatëse të së Drejtës Ndërkombëtare në këtë fushë, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
7. Dokumentacioni që merret me kërkesë të personit, duhet të jetë lëshuar jo më parë se 3 (tre) muaj nga dorëzimi i kërkesës për licencim.
8. Subjekti kërkues i licencës është përgjegjës për vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar në Autoritet.

Neni 10

Kërkesa për veprimtari shtesë

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, bursa/ operatori që vë në funksion një treg të rregulluar ka të drejtë t'i kërkojë Autoritetit të lejohet të kryejë një veprimtari shtesë.
2. Kërkesa për të ushtruar veprimtari shtesë bëhet nga Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës i bursës/operatorit të tregut.

Neni 11
Tarifa e aplikimit

1. Subjekti që kërkon dhënien e licencës, paguan një tarifë në momentin e paraqitjes së kërkesës, e cila përcaktohet nga Autoriteti.
2. Tarifa e përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, nuk kthehet edhe në rast të refuzimit të kërkesës nga Autoriteti. Subjektit kërkues i lind detyrimi i pagesës së një tarife të përcaktuar sipas rregullores në fuqi për përcaktimin e elementëve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura.

KREU III
KËRKESAT OPERACIONALE PËR BURSAT DHE OPERATORËT E TREGUT QË
VËNË NË FUNKSION NJË TREG TË RREGULLUAR

Neni 12
Detyrimi për ofrimin e të dhënave

1. Me qëllim vënien në dispozicion të të dhënave të tregut publikut, operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar duhet të respektojnë detyrimet e përcaktuara në këtë nen.
2. Gjatë vënies në dispozicion të të dhënave të tregut për publikun, operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar duhet të sigurojnë akses jodiskriminues të informacioneve. Për këtë qëllim, duhet të përdoren mjete teknike që sigurojnë aksesueshmërinë, lexueshmërinë dhe mirëmbajtjen në një mjet të qëndrueshëm komunikimi.
3. Informacionet vihen në dispozicion pa pagesë 15 minuta pas publikimit.
4. Pikat 5, 6, 8, 9, 10, 11 dhe nga pika 14 deri në pikën 16 të këtij neni nuk do të zbatohen për operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar që i vendosin të dhënat e tregut në dispozicion të publikut pa pagesë.
5. Çmimi i të dhënave të tregut do të bazohet në koston e përpunimit dhe shpërndarjes së atyre të dhënave dhe mund të përfshijë një marzh të arsyeshëm.
6. Kostoja e përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave të tregut mund të përfshijë një pjesë të përshtatshme të kostove të përbashkëta për shërbime të tjera të ofruara nga operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar.
7. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar duhet t'i vënë në dispozicion të dhënat e tregut me të njëjtin çmim dhe me të njëjtat terma dhe kushte për të gjithë klientët që bëjnë pjesë në të njëjtën kategori në përputhje me kriteret objektive të publikuara.
8. Çdo diferencë në çmimet e tarifuara për kategori të ndryshme klientësh do të jetë në proporcion me vlerën që përfaqësojnë të dhënat e tregut për këta klientë, duke marrë në konsideratë:

- a) Objektin dhe shkallën e të dhënave të tregut duke përfshirë numrin e instrumenteve financiare të mbuluara dhe vëllimin e tyre të tregtimit;
 - b) Përdorimin e të dhënave të tregut nga klienti, duke përfshirë ato që përdoren për aktivitetin e tregtimit të vetë klientit, për rishitje ose për grumbullimin e të dhënave.
9. Për qëllim të pikës 7 të këtij neni, operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar duhet të kenë kapacitete të shkallëzuara për të siguruar që klientët kanë akses në kohën e duhur në të dhënat e tregut në çdo kohë në mënyrë jodiskriminuese.
10. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar tarifojnë sipas përdorimit të të dhënave të tregut përdoruesit përfundimtarë individualë (“për çdo përdorues”). Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar duhet të zbatojnë procedura për të siguruar që çdo përdorim individual i të dhënave të tregut të tarifohet vetëm një herë.
11. Me përjashtim të pikës 10, të këtij neni, operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar mund të vendosin që të mos i bëjnë të disponueshme të dhënat e tregut për çdo përdorues ku tarifimi për çdo përdorues është në shpërpjesëtim me koston e vënies në dispozicion të këtyre të dhënave, duke pasur parasysh shkallën dhe objektin e të dhënave.
12. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar duhet të tregojnë arsyet për refuzimin e vënies në dispozicion të të dhënave të tregut për çdo përdorues dhe t'i publikojnë arsyet e refuzimit në faqen e tyre të internetit.
13. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar duhet të vënë në dispozicion të dhënat e tregut pa i bashkuar me shërbime të tjera.
14. Çmimet për të dhënat e tregut para dhe pas tregtimit do të tarifohen veçmas për efekt transparence, sipas Shtojcës III të kësaj rregulloreje.
15. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar duhet të shfaqin çmimin, termat dhe kushtet e tjera për ofrimin e të dhënave të tregut në një mënyrë që të jetë lehtësisht e aksesueshme për publikun.
16. Dhënia e informacioneve duhet të përfshijë sa vijon:
- a) Listat e çmimeve aktuale, duke përfshirë:
 - (i) tarifat për çdo përdorues sistemi (të dhënat që ofrohen ose përdoren nëpërmjet mbështetjes së një monitori ose një ekrani dhe që janë të lexueshme nga njeriu);
 - (ii) tarifat për informacionet që nuk afishohen në ekran (të gjitha të dhënat që nuk plotësojnë përkufizimin e të dhënave që afishohen në ekran);
 - (iii) politikat e skontos (discount);
 - (iv) tarifat që lidhen me kushtet e licencës;
 - (v) tarifat për të dhënat e tregut para dhe pas tregtimit;
 - (vi) tarifat për nëngrupe të tjera informacioni, duke përfshirë të dhënat e ndara para dhe pas tregtimit;

- (vii) terma dhe kushte të tjera kontraktuale në lidhje me listën e çmimeve aktuale;
- b) Njoftim paraprak minimalisht prej 90 ditësh për ndryshimet e ardhshme të çmimeve;
- c) Informacione mbi përmbajtjen e të dhënave të tregut duke përfshirë:
 - (i) numrin e instrumenteve financiare;
 - (ii) qarkullimin total të instrumenteve financiare;
 - (iii) raporti i të dhënave të tregut para dhe pas tregtimit;
 - (iv) çdo informacion tjetër të nevojshëm që nuk konsiderohet e dhënë tregu;
- d) Të ardhurat e marra nga vënia në dispozicion e të dhënave të tregut dhe përqindja e atyre të ardhurave krahasuar me të ardhurat totale të operatorit të tregut që vë në funksion një treg të rregulluar;
- e) Informacione mbi mënyrën se si është vendosur çmimi, duke përfshirë metodologjitë e kontabilitetit të kostos të përdorura dhe parimet specifike sipas të cilave shpërndahen kostot e përbashkëta të drejtpërdrejta dhe të ndryshueshme dhe kostot e përbashkëta fikse, ndërmjet prodhimit dhe shpërndarjes së të dhënave të tregut dhe shërbimeve të tjera të ofruara nga operatori i tregut që vë në funksion një treg të rregulluar.

Neni 13

Pranimi i instrumenteve financiare për tregtim në një treg të rregulluar

1. Operatori i tregut që vë në funksion një treg të rregulluar duhet të ketë rregulla të qarta dhe transparente në lidhje me pranimin për tregtim të instrumenteve financiare.

Këto rregulla sigurojnë se çdo instrument financiar i pranuar për tregtim në një treg të rregulluar do të tregtohen në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase dhe në rastin e titujve të transferueshëm, të jetë lirisht i negociueshëm.

2. Kriteret që specifikojnë karakteristikat e klasave të ndryshme të instrumenteve financiare, të cilat duhet të merren parasysh nga tregu i rregulluar kur vlerësohet nëse një instrument financiar është emetuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për t'u pranuar në tregtim në segmente të ndryshme të tregut, përcaktohen në Shtojcën II të kësaj rregulloreje.
3. Në rastin e derivativëve, rregullat e përmendura në pikën 1, të këtij neni sigurojnë në veçanti se struktura e kontratës së derivativit mundëson vendosjen e çmimit të drejtë si dhe kushteve efikase të shlyerjes.
4. Operatori i tregut që vë në funksion një treg të rregulluar duhet të krijojë dhe mbajë procedura efikase për të verifikuar se emetuesit e titujve të transferueshëm që janë pranuar për tregtim në tregun e rregulluar janë në përputhje me detyrimet e tyre sipas Ligjit dhe rregulloreve në fuqi në lidhje me dhënien e informacionit në mënyrë të vazhdueshme.

5. Operatori i tregut që vë në funksion një treg të rregulluar duhet të ketë procedura për të rishikuar rregullisht përputhshmërinë me kriteret e pranimit të instrumenteve financiare të pranuar për tregtim.

Neni 14

Pezullimi dhe heqja e instrumenteve financiare nga tregtimi në një treg të rregulluar

1. Në përputhje me nenin 147, pika 4, shkronja d) nënpika viii), të Ligjit dhe pa cenuar të drejtat e Autoritetit për pezullim apo heqje të instrumentit financiar, operatori i tregut mund të pezullojë ose heqë nga tregtimi një instrument financiar, i cili nuk përputhet më me rregullat e një tregu të rregulluar të përcaktuar në ligj dhe në këtë rregullore, përveç rasteve kur ai pezullim apo ajo heqje mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme të interesave të investitorëve ose funksionimin e rregullt të tregut.
2. Operatori i tregut që pezullon ose heq nga tregtimi një instrument financiar duhet të pezullojë ose heqë gjithashtu derivativët që lidhen ose i referohen atij instrumenti financiar kur është e nevojshme për të mbështetur objektivat e pezullimit ose heqjes së instrumentit financiar bazë. Operatori i tregut bën publik pa vonesë nëpërmjet faqes së tij të internetit vendimin e tij për pezullimin ose heqjen e instrumentit financiar dhe të çdo derivativi të lidhur me të dhe i komunikon vendimet përkatëse Autoritetit.
3. Autoriteti kërkon që tregjet e tjera të rregulluara, të cilat tregtojnë të njëjtin instrument financiar ose derivativë që lidhen ose i referohen atij instrumenti financiar, gjithashtu të pezullojnë ose heqin nga tregtimi atë instrument financiar ose derivativ, kur pezullimi ose heqja është për shkak të dyshimit të abuzimit me tregun, një “take-over bid” (ofertë për marrjen në kontroll të një shoqërie me ofertë publike) ose mosdhënies së informacioneve të privileguara në lidhje me emetuesin ose instrumentin financiar që është në shkelje të rregullores në fuqi për ndalimin e abuzimit me tregun, përveç rasteve kur ai pezullim ose ajo heqje mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në interesat e investitorëve ose funksionimin e rregullt të tregut.

Autoriteti e bën publik menjëherë këtë vendim nëpërmjet faqes së tij të internetit.

Ky paragraf zbatohet gjithashtu kur hiqet pezullimi nga tregtimi i një instrumenti financiar ose derivativëve që lidhen ose i referohen atij instrumenti financiar.

Neni 15

Kriteret para dhe pas tregtimit për bursat dhe operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar

Operatori i tregut që vë në funksion një treg të rregulluar duhet të veprojë në përputhje me kriteret e para tregtimit dhe pas tregtimit, siç përcaktohet në Shtojcën III të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Kërkesat specifike për organin drejtues

1. Të gjithë anëtarët e organit drejtues të çfarëdo operatori tregu duhet të kenë integritet, të kenë njohuri, aftësi dhe përvojë të mjaftueshme për të kryer detyrat e tyre. Përbërja e përgjithshme e organit drejtues duhet të pasqyrojë një gamë mjaft të gjerë përvojë.
2. Anëtarët e organit drejtues, në veçanti, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të gjithë anëtarët e organit drejtues duhet t'i kushtojnë kohë të mjaftueshme kryerjes së funksioneve të tyre në operatorin e tregut. Përcaktimi i numrit të posteve drejtuese që një anëtar i organit drejtues mund të mbajë, në çdo person juridik, në të njëjtën kohë duhet të marrë parasysh rrethanat individuale dhe natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të operatorit të tregut. Në vlerësimin e angazhimit të mjaftueshëm kohor të një anëtari të organit drejtues, duhet të merren në konsideratë të paktën sa vijon:
 - (i) numri i posteve drejtuese në shoqëritë financiare dhe jo financiare të mbajtura nga ai anëtar në të njëjtën kohë, duke marrë parasysh sinergjitë e mundshme kur ato mbahen brenda të njëjtit grup, përfshirë kur veprojnë në emër të një personi juridik ose si zëvendësues të një anëtari të organit drejtues;
 - (ii) madhësia, natyra, objekti dhe kompleksiteti i aktiviteteve të njësisë ekonomike ku anëtari mban një post drejtues;
 - (iii) prania gjeografike e anëtarit dhe koha e kërkuar e udhëtimit për atë detyrë;
 - (iv) numri i takimeve të planifikuara për organin drejtues;
 - (v) postet drejtuese në organizata që nuk ndjekin objektiva kryesisht komerciale të mbajtura nga ai anëtar në të njëjtën kohë;
 - (vi) çdo takim të nevojshëm që do të mbahet, në veçanti, me autoritetet kompetente ose aktorë të tjerë të brendshëm ose të jashtëm jashtë orarit të takimeve zyrtare të organit drejtues;
 - (vii) natyrën e pozicionit specifik dhe përgjegjësitë e anëtarit, duke përfshirë detyrat specifike si administrator, kryetar, ose anëtar i një keshilli, nëse anëtari mban një pozicion ekzekutiv ose jo ekzekutiv, si dhe nevojën e atij anëtari për të marrë pjesë në takime në shoqëritë e listuara në shkronjën a) nën-pika i), të këtij neni, dhe në institucion;

- (viii) aktivitete të tjera të jashtme profesionale ose politike, si dhe çdo funksion dhe veprimtari tjetër përkatëse, brenda dhe jashtë sektorit financiar dhe brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;
- (ix) trajnimin e nevojshëm; dhe
- (x) çdo detyrë tjetër përkatëse të anëtarit që institucionet e konsiderojnë të nevojshme për t'u marrë në konsideratë gjatë kryerjes së vlerësimit të angazhimit të mjaftueshëm kohor të një anëtari.

Anëtarët e organit drejtues të operatorit të tregut nuk duhet të mbajnë në të njëjtën kohë pozicione që tejkalojnë më shumë se një nga kombinimet e mëposhtme:

- (i) një post drejtues ekzekutiv me dy poste drejtuese jo ekzekutive;
 - (ii) katër poste drejtuese jo ekzekutive;
 - (iii) Postet drejtuese ekzekutive dhe jo ekzekutive të mbajtura brenda të njëjtit grup ose shoqëri ku operatori i tregut zotëron një pjesëmarrje influencuese do të konsiderohen si një post drejtues i vetëm;
 - (iv) Postet drejtuese në organizata që nuk ndjekin objektiva kryesisht komerciale do të përjashtohen nga kufizimi i numrit të posteve drejtuese që mund të mbajë një anëtar i një organi drejtues.
- b) Organi drejtues duhet të ketë njohuri, aftësi dhe përvojë të përshtatshme kolektive për të kuptuar aktivitetet e operatorit të tregut, duke përfshirë rreziqet kryesore. Në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe përvojës së përshtatshme të një anëtari të organit drejtues, duhet të merren parasysh të paktën sa vijon:
- (i) roli dhe detyrat e pozicionit dhe aftësitë e kërkuara;
 - (ii) njohuritë dhe aftësitë e fituara nëpërmjet edukimit, trajnimit dhe praktikës;
 - (iii) përvoja praktike dhe profesionale e fituar në pozicionet e mëparshme; dhe
 - (iv) njohuritë dhe aftësitë e fituara dhe të demonstruara nga sjellja profesionale e anëtarit të organit drejtues.
- c) Çdo anëtar i organit drejtues vepron me ndershmëri, integritet dhe pavarësi mendimi për të vlerësuar dhe sfiduar në mënyrë efikase vendimet e menaxhimit të lartë aty ku është e nevojshme dhe për të mbikëqyrur dhe monitoruar në mënyrë efikase vendimmarrjen.

Në vlerësimin e pavarësisë së mendimit të një anëtari të organit drejtues, duhet të merren në konsideratë të paktën sa vijon:

- (i) aftësitë e nevojshme të sjelljes, duke përfshirë guximin, bindjen dhe forcën për të vlerësuar dhe sfiduar në mënyrë efikase vendimet e propozuara të anëtarëve të tjerë të organit drejtues, aftësia për t'u bërë pyetje anëtarëve të organit drejtues në funksionin e tij drejtues dhe aftësia për t'i rezistuar "mendimit në grup".

- (ii) konfliktet e interesit në një masë që do të pengonte aftësinë e tyre për të kryer detyrat e tyre në mënyrë të pavarur dhe objektive.
3. Operatori i tregut/bursa i kushton burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare formimit dhe trajnimit të anëtarëve të organit drejtues.
 4. Në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të aktivitetit, operatori i tregut/bursa krijon një Komitet Emërimi të përbërë nga anëtarë të organit drejtues të cilët nuk kryejnë asnjë funksion ekzekutiv në operatorin e tregut në fjalë.

Komiteti i Emërimit do të kryejë sa vijon:

- a) Identifikimin dhe rekomandimin, për miratimin e organit drejtues ose për miratimin e mbledhjes së përgjithshme, kandidatët për të plotësuar vendet vakante të organeve drejtuese si më poshtë:
 - (i) Komiteti i Emërimit vlerëson balancën e njohurive, aftësive, diversitetit dhe përvojës së organit drejtues;
 - (ii) Komiteti i Emërimit përgatit një përshkrim të roleve dhe aftësive për një emërim të caktuar dhe vlerëson angazhimin e pritur kohor;
 - (iii) Komiteti i Emërimit vendos për një objektiv për përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar në organin drejtues dhe përgatit një politikë se si të rritet numri i gjinisë së nënpërfaqësuar në organin drejtues.
- b) Në mënyrë periodike, dhe të paktën një herë në vit, Komiteti vlerëson strukturën, madhësinë, përbërjen dhe performancën e organit drejtues dhe i jep rekomandime organit drejtues në lidhje me çdo ndryshim;
- c) Në mënyrë periodike, dhe të paktën një herë në vit, vlerëson njohuritë, aftësitë dhe përvojën e anëtarëve individualë të organit drejtues dhe të organit drejtues kolektivisht, dhe i raporton organit drejtues në përputhje me rrethanat;
- d) Rishikon periodikisht politikën e organit drejtues për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtuesve të lartë dhe i jep rekomandime organit drejtues.

Në kryerjen e detyrave të tij, Komiteti i Emërimit, për aq sa është e mundur dhe në mënyrë të vazhdueshme, merr parasysh nevojën për të siguruar që vendimmarrja e organit drejtues nuk dominohet nga asnjë individ ose grup i vogël individësh në një mënyrë që dëmton interesat e operatorit të tregut në tërësi.

Në kryerjen e detyrave të tij, Komiteti i Emërimit përdor çdo formë burimi që e gjykon të përshtatshme, duke përfshirë këshillimin e jashtëm.

5. Operatorët e tregut/bursat dhe komitetet e tyre përkatëse të emërimit angazhojnë një gamë të gjerë cilësish dhe kompetencash kur rekrutojnë anëtarë në organin drejtues dhe për këtë qëllim zbatojnë një politikë që promovon diversitetin në organin drejtues. Politika e diversitetit duhet t'u referohet të paktën aspekteve të diversitetit të formimit arsimor dhe profesional, gjinisë dhe moshës.

6. Organi drejtues i një operatori tregu/burse përcakton dhe mbikëqyr zbatimin e rregullave të qeverisjes që sigurojnë menaxhim efikas dhe të kujdesshëm të një organizate, duke përfshirë ndarjen e detyrave në organizatë dhe parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe në një mënyrë të tillë që promovon integritetin e tregut.

Organi drejtues monitoron dhe vlerëson periodikisht efikasitetin e aranzhimeve të qeverisjes së operatorit të tregut dhe merr masat e duhura për të adresuar çdo mangësi.

Anëtarët e organit drejtues duhet të kenë akses në informacionin dhe dokumentet që nevojiten për të mbikëqyrur dhe monitoruar vendimmartjen e menaxhimit të lartë.

7. Autoriteti refuzon licencimin nëse nuk bindet se anëtarët e organit drejtues të operatorit të tregut/bursës kanë reputacion mjaftueshëm të mirë, zotërojnë njohuri, aftësi dhe përvojë të mjaftueshme dhe i kushtojnë kohë të mjaftueshme kryerjes së funksioneve të tyre, ose nëse ka arsye objektive dhe të vërtetueshme për të besuar se organi drejtues i operatorit të tregut/bursës mund të përbëjë një kërcënim për menaxhimin efikas, të plotë dhe të kujdesshëm të tij, dhe për vlerësimin e duhur të integritetit të tregut.
8. Operatori i tregut/bursa njofton autoritetin kompetent për identitetin e të gjithë anëtarëve të organit të tij drejtues dhe për çdo ndryshim në anëtarësimin e tij, së bashku me të gjitha informacionet e nevojshme për të vlerësuar nëse operatori i tregut është në përputhje me pikat 1 deri në 5 të këtij neni.

Neni 17

Aksesi në një treg të rregulluar të një operatori tregu që vë në funksion një treg të rregulluar

1. Operatori i tregut që vë në funksion një treg të rregulluar vendos, zbaton dhe mban rregulla transparente dhe jo diskriminuese, bazuar në kritere objektive, që rregullojnë aksesin ose anëtarësimin në tregun e rregulluar.
2. Rregullat e referuara në pikën 1, të këtij neni përcaktojnë çdo detyrim për anëtarët ose pjesëmarrësit që rrjedhin nga:
 - a) Themelimi dhe administrimi i tregut të rregulluar;
 - b) Rregullat për transaksionet në treg;
 - c) Standardet profesionale të vendosura për personelin e shoqërive komisionere ose bankave që operojnë në treg;
 - d) Kushtet e përcaktuara, për anëtarët ose pjesëmarrësit, përveç shoqërive komisionere dhe bankave, sipas pikës 3, të këtij neni;
 - e) Rregullat dhe procedurat për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve në tregun e rregulluar.
3. Tregjet e rregulluara mund të pranojnë si anëtarë ose pjesëmarrës shoqëri komisionere, banka të licencuara për të ofruar shërbime investimi dhe persona të tjerë që kanë reputacion të mirë:
 - a) Kanë një nivel të mjaftueshëm aftësie, kompetence dhe përvojë tregtimi;

- b) Kanë masat e duhura organizative aty ku është e nevojshme;
- c) Kanë burime të mjaftueshme për rolin që duhet të kryejnë, duke marrë parasysh marrëveshjet e ndryshme financiare që tregu i rregulluar mund të ketë krijuar për të garantuar shlyerjen e duhur të transaksioneve.

Neni 18

Kriteret për kapitalin e bursave/ operatorëve të tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar

1. Në përputhje me nenin 142, pikat 3 dhe 5, të Ligjit, kapitali fillestar i regjistruar i bursës/operatorit të tregut do të jetë 85.000.000,00 Lekë dhe duhet të paguhet plotësisht në vlerë monetare.
2. Operatori i tregut/bursa që vë në funksion një treg të rregulluar duhet të ketë burime të mjaftueshme financiare për zhvillimin e duhur të operacioneve të bursës, duke marrë në konsideratë natyrën, objektin dhe strukturën e rrezikut të transaksioneve të kryera në bursë/ në tregun e rregulluar.
3. Burimet financiare të parashikuara në pikën 2, të këtij neni duhet të jenë të paktën sa 1/3 e shpenzimeve vjetore të vitit të mëparshëm, në formë likuide me maturitet 1 vjeçar.

Neni 19

Kriteret e raportimit për bursat dhe operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar

1. Bursa/operatori i tregut i dorëzon Autoritetit pasqyrat financiare vjetore siç kërkohet në nenin 154, pika 2 dhe në përputhje me nenin 154, pika 3, të Ligjit, brenda 4 muajve pas përfundimit të vitit financiar.
2. Bursa/operatori i tregut është subjekt i kriterëve të raportimit në përputhje me nenin 154, pikat 5 dhe 6, të Ligjit.
3. Bursa/operatori i tregut raporton menjëherë çdo rast të tregtimit bazuar në informacion të privilegjuar në përputhje me rregulloren për abuzimin me tregun. Bursa/operatori i tregut gjithashtu raporton çdo veprimtari mbi pastrimin e parave menjëherë, dhe jo më vonë se 72 orë, duke përdorur modelin në Shtojcën IV të kësaj rregulloreje.
4. Këshilli Mbikëqyrës/Këshilli Administrimit i bursës/operatorit të tregut i raporton Autoritetit çdo muaj, deri në ditën e pestë të muajit pasardhës, për blerjen ose shitjen e titujve të zotëruar nga anëtarët e Këshillit të Administrimit, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe funksionarët kryesorë të bursës në vijim, sipas nenit 154, pikat 6 dhe 7 të Ligjit duke përdorur formularin në Shtojcën V të kësaj rregulloreje.

KREU IV SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I KËRKESËS PËR LICENCIM

Neni 20 Shqyrtimi nga Autoriteti

1. Autoriteti vlerëson nëse aplikimi është i plotë brenda 30 ditë pune nga marrja e tij. Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, Autoriteti cakton një afat kohor prej 10 ditësh pune brenda të cilit subjekti kërkues duhet të japë informacion shtesë.
2. Autoriteti njofton subjektin kërkues për vendimin e tij në lidhje me miratimin e kërkesës për licencim brenda 6 muajve nga dorëzimi i aplikimit të plotë.
3. Kur Autoriteti nuk merr një vendim për miratim brenda afateve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, aplikimi nuk konsiderohet i miratuar.
4. Kur Autoriteti konstaton se aplikimi nuk plotëson standardin e plotësisë dhe nuk provon përputhshmërinë me Ligjin dhe këtë rregullore dhe/ose konstatohen mangësi ose parregullsi dhe/ose nevojiten ndryshime, ose informacione shtesë, Autoriteti:
 - a) Informon subjektin kërkues në formë të shkruar ose elektronike për këtë fakt brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, të llogaritur nga dorëzimi i aplikimit në përputhje me pikën 1, të këtij neni; dhe
 - b) Specifikon qartë ndryshimet ose informacionet plotësuese që janë të nevojshme në përputhje me Ligjin dhe këtë rregullore. Në rastet e parashikuara në pikën 4, të këtij neni, afati kohor i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni do të zbatohet që nga data në të cilën Autoritetit i është dorëzuar dokumentacioni i plotë i rishikuar për aplikim.
5. Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.

Neni 21 Refuzimi ose heqja e licencës

1. Në përputhje me nenin 148 të Ligjit, Autoriteti nuk miraton të drejtën për marrjen e një licence si operator tregu/bursë, përveçse nëse dhe deri në momentin kur subjekti kërkues përmbush të gjitha kërkesat sipas dispozitave në përputhje me nenet 143 deri në 147 të Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti mund të heqë licencën e një burse të licencuar dhe operatorit të tregut që vë në funksion një treg të rregulluar, nëse ata nuk e përdorin licencën për të vënë në funksion një bursë dhe/ose një treg të rregulluar, siç referohet në nenin 5 dhe nenin 11 të kësaj rregulloreje brenda periudhës prej 12 muajsh.
3. Autoriteti mund t'i heqë licencën një burse/operatori të tregut që vë në funksion një treg të rregulluar nëse subjekti kërkues:

- a) Ka marrë miratimin duke bërë deklarata të rreme ose ndonjë parregullsi tjetër; ose
- b) Nuk plotëson më kriteret sipas të cilave është dhënë licencimi.

KREU V

DETYRIME TË MËTEJSHME TË PËRGJITHSHME PËR OPERATORËT E TREGUT

Neni 22

Dhënia e informacioneve për Autoritetin

1. Operatori i tregut/bursa njofton Autoritetin për çdo ndryshim me ndikim material si dhe një përshkrim të këtyre ndryshimeve.
2. Kur operatori i tregut/bursa i dërgon një informacion të ri Autoritetit për të korrigjuar, përditësuar ose sqaruar informacionin e paraqitur më parë në përputhje me këtë rregullore, nuk është e nevojshme përfshirja e informacioneve me një natyrë të vogël ose teknike, që nuk përbën rëndësi në vlerësimin për përputhshmërinë e tij me nenin 6, pikat 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje.
3. Subjektet sipas kësaj rregulloreje kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriteve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriteve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Subjektet depozitojnë në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individ mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriteve.

Neni 23

Mbi detyrimin për zbatimin e rregullores në fuqi

Operatorët e tregut/bursat zbatojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në rregulloren në fuqi për “Ndalimin e Abuzimit me tregun”.

KREU VI

SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MASAT MBIKËQYRËSE

Neni 24

Monitorimi i tregut

Autoriteti gjatë monitorimit të veprimtarisë së operatorëve të tregut dhe vetë tregut, në rast konstatimi të shkeljes së ndonjë prej kërkesave të Ligjit dhe kësaj rregulloreje vendos sanksione apo ndërmerr masa mbikëqyrëse.

Neni 25

Ndalimi dhe kufizimi i përkohshëm i disa aktiviteteve financiare

Autoriteti mund të ndalojë ose kufizojë përkohësisht disa aktivitete financiare që lidhen me tregjet e kapitalit në raste emergjente të zhvillimeve të pafavorshme që mund të rrezikojnë seriozisht funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve financiare ose stabilitetin e një pjese ose të gjithë sistemit financiar (rastet emergjente).

Neni 26

Kompetencat për ndërhyrjen në produkt

1. Në rastet emergjente të përcaktuara në nenin 25 të kësaj rregulloreje, Autoriteti, në rastet kur plotësohen kushtet në pikën 2, të këtij neni, mund të ndalojë ose kufizojë përkohësisht:
 - a) Marketingun, shpërndarjen ose shitjen e instrumenteve të caktuara financiare ose instrumenteve financiare me karakteristika të caktuara specifike; ose
 - b) Një lloj aktiviteti ose praktike financiare.
2. Autoriteti mund të ndërmarrë veprimin e referuar në pikën 1 të këtij neni, nëse në baza të arsyeshme bindet se/ose:
 - a) Një instrument financiar, depozitë e strukturuar ose ndonjë aktivitet ose praktikë tregu çënon në mënyrë të konsiderueshme mbrojtjen e investitorëve ose përbën një kërcënim për funksionimin dhe integritetin e rregullt të tregjeve financiare ose për stabilitetin e të gjithë ose një pjese të sistemit financiar; ose

Një derivativ ka një efekt të dëmshëm në mekanizmin e formimit të çmimit në tregun bazë;
 - b) Kriteret rregullatore ekzistuese të zbatueshme për instrumentin financiar, depozitën e strukturuar ose aktivitetin ose praktikën nuk trajtojnë mjaftueshëm risqet e referuara në pikën 2, shkronja a);
 - c) Veprimi është proporcional duke marrë parasysh natyrën e risqeve të identifikuar, nivelin e sofistikimit të investitorëve ose pjesëmarrësve në tregun përkatës dhe efektin e mundshëm të veprimit të investitorët dhe pjesëmarrësit në treg që mund të mbajnë, përdorin ose përfitojnë nga instrumenti financiar, depozita e strukturuar ose veprimtaria apo praktika.
3. Kur përcaktohet nëse ekziston një dëmtim i konsiderueshëm lidhur me mbrojtjen e investitorëve ose një kërcënim për funksionimin dhe integritetin e rregullt të tregjeve financiare ose për stabilitetin e sistemit financiar të referuar në pikën 2, shkronja a) të këtij neni, merren në konsideratë kriteret e specifikuar në nenin 27 të kësaj rregulloreje.
4. Në kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, Autoriteti mund të vendosë ndalimin ose kufizimin e referuar në pikën 1 të këtij neni mbi baza paraprake përpara se një instrument financiar të tregtohet, shpërndahet ose shitet tek klientët.
5. Ndalimi ose kufizimi mund të zbatohet në rrethana të caktuara ose të jetë subjekt i përjashtimeve të specifikuar nga Autoriteti.

6. Kur ndërmerr veprime sipas këtij neni, Autoriteti siguron se veprimi:
 - a) Nuk ka një efekt të dëmshëm në efikasitetin e tregjeve financiare ose mbi investitorët;
 - b) Nuk krijon risk për arbitrazh rregullator.
7. Autoriteti publikon në faqen e tij të internetit njoftimin për çdo vendim për të ndërmarrë çfarëdolloj veprimi sipas këtij neni. Njoftimi specifikon detajet e ndalimit ose kufizimit, pak kohë pas publikimit të njoftimit nga i cili do të hyjnë në fuqi masat dhe provat mbi të cilat plotësohet secili prej kushteve në pikën 2 të këtij neni. Ndalimi ose kufizimi zbatohet vetëm në lidhje me veprimet e ndërmarra pas publikimit të njoftimit.
8. Autoriteti shqyrton një ndalim ose kufizim të vendosur sipas pikës 1 të këtij neni në intervale të përshtatshme dhe të paktën çdo tre muaj. Autoriteti revokon një ndalim ose kufizim nëse nuk zbatohen më kushtet e parashtruara në pikën 2 të këtij neni. Nëse ndalimi ose kufizimi nuk rinovohet pas një periudhe tre mujore, ai merr fund automatikisht.

Neni 27

Kriteret dhe faktorët që duhet të merren parasysh nga Autoriteti për qëllime të kompetencave të ndërhyrjes së produktit

1. Për qëllimet e nenit 26, pika 2, shkronja a) të kësaj rregulloreje, Autoriteti vlerëson rëndësinë e të gjithë faktorëve dhe kriterëve të renditura në pikën 2 të këtij neni dhe merr në konsideratë të gjithë faktorët dhe kriteret përkatëse në përcaktimin e kohës kur marketingu, shpërndarja ose shitja e instrumenteve të caktuara financiare ose depozitave të strukturuar, ose instrumenteve financiare ose depozitave të strukturuar me karakteristika të caktuara specifike ose një lloj aktiviteti ose praktike financiare krijon një shqetësim të rëndësishëm për mbrojtjen e investitorëve ose një kërcënim për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve financiare ose për stabilitetin e të gjithë ose një pjese të sistemit financiar.

Për qëllim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti mund të përcaktojë ekzistencën e një dëmtimi të konsiderueshëm në lidhje me mbrojtjen e investitorëve ose një kërcënim për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve financiare ose për stabilitetin e të gjithë ose një pjese të sistemit financiar bazuar në një ose më shumë faktorë dhe kriterë të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Faktorët dhe kriteret që vlerësohen nga Autoriteti për të përcaktuar nëse ekziston një dëmtim i konsiderueshëm në lidhje me mbrojtjen e investitorëve ose një kërcënim për funksionimin dhe integritetin e rregullt të tregjeve financiare ose për stabilitetin e të gjithë ose një pjese të sistemit financiar përfshin sa vijon:
 - a) Shkallën e kompleksitetit të instrumentit financiar ose llojin e aktivitetit ose praktikës financiare në lidhje me llojin e klientëve, siç vlerësohet në përputhje me shkronjën c), të përfshirë në aktivitetin financiar ose praktikën financiare, ose të cilëve instrumenti financiar ose depozita e strukturuar u tregtohet ose shitet, duke marrë parasysh, në veçanti:
 - (i) llojin e aseteve bazë ose referuese dhe shkallën e transparencës së aktiveve bazë ose referuese;

- (ii) shkallën e transparencës së kostove dhe tarifave të lidhura me instrumentin financiar, depozitën e strukturuar, aktivitetin financiar ose praktikën financiare, dhe, në veçanti, mungesën e transparencës që rezulton nga shtresëzimet e shumëfishta të kostove dhe tarifave;
 - (iii) kompleksitetin e llogaritjes së performancës, duke marrë parasysh nëse kthimi varet nga performanca e një ose më shumë aseteve bazë ose referuese, të cilat nga ana tjetër ndikohen nga faktorë të tjerë ose nëse kthimi varet jo vetëm nga vlerat e aseteve bazë ose referuese në datat fillestare dhe të maturimit, por edhe nga vlerat gjatë jetëgjatësisë së produktit;
 - (iv) natyrën dhe shkallën e çfarëdo risku;
 - (v) nëse produkti ose shërbimi është i bashkuar me produkte ose shërbime të tjera;
 - (vi) kompleksitetin e çdo termi dhe kushti;
- b) Madhësinë e pasojave të dëmshme të mundshme, duke marrë në konsideratë në veçanti:
- (i) vlerën nocionale të instrumentit financiar ose të një emetimi të depozitave të strukturuar;
 - (ii) numrin e klientëve, investitorëve ose pjesëmarrësve në treg të përfshirë;
 - (iii) peshën relative të produktit në portofolet e investitorëve;
 - (iv) probabilitetin, shkallën dhe natyrën e çdo dëmi, duke përfshirë shumën e humbjes së pësuar potencialisht;
 - (v) kohëzgjatjen e parashikuar të pasojave të dëmshme;
 - (vi) vëllimin e emetimit;
 - (vii) numrin e ndërmjetësve të përfshirë;
 - (viii) rritjen e tregut ose të shitjeve;
 - (ix) shumën mesatare të investuar nga çdo klient në instrumentin financiar ose depozitën e strukturuar; ose
- c) Llojin e klientëve të përfshirë në një aktivitet financiar ose praktikë financiare ose të cilëve u marketohet ose shitet një instrument financiar ose depozitë e strukturuar, duke marrë në konsideratë, në veçanti:
- (i) nëse klienti është një klient joprofesionist, një klient profesionist ose një palë e pranueshme;
 - (ii) aftësitë dhe zotësitë e klientëve, duke përfshirë nivelin e arsimimit, përvojën me instrumente të ngjashme financiare ose depozita të strukturuar ose praktika shitjeje;
 - (iii) situatën ekonomike të klientëve, duke përfshirë të ardhurat dhe pasurinë e tyre;

- (iv) objektivat kryesore financiare të klientëve, duke përfshirë kursimet e pensioneve dhe financimin e pronësisë së shtëpisë;
 - (v) nëse produkti ose shërbimi u shitet klientëve jashtë tregut të synuar ose kur tregu i synuar nuk është identifikuar në mënyrën e duhur; ose
 - (vi) pranueshmërinë për mbulim nga një skemë e garancisë së depozitave, në rastin e depozitave të strukturuar;
- d) Shkallën e transparencës së instrumentit financiar, depozitës së strukturuar ose llojit të aktivitetit ose praktikës financiare, duke marrë në konsideratë, në veçanti:
- (i) llojin dhe transparencën e asetit bazë;
 - (ii) çdo kosto dhe tarifë të fshehur;
 - (iii) përdorimin e teknikave që tërheqin vëmendjen e klientëve, por që nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht përshtatshmërinë ose cilësinë e përgjithshme të produktit, aktivitetin financiar ose praktikën financiare;
 - (iv) natyrën e risqeve dhe transparencën e risqeve;
 - (v) përdorimin e emrave të produkteve ose terminologjisë ose informacione të tjera që janë keqorientuese duke nënkuptuar një nivel më të madh sigurie ose kthimi sesa ato që janë realisht të mundshme ose që nënkuptojnë veçori të produktit që nuk ekzistojnë; ose
 - (vi) në rastin e depozitave të strukturuar, nëse zbulohet identiteti i depozituesve që mund të jenë përgjegjës për depozitën e klientit.
- e) Veçoritë ose përbërësit e depozitës së strukturuar, instrumentit financiar, aktivitetit financiar ose praktikës financiare, duke përfshirë “embedded leverage”, duke marrë parasysh, në veçanti:
- (i) levën financiare që përfshihet në produkt;
 - (ii) levën financiare për shkak të financimit;
 - (iii) veçoritë e transaksioneve të financimit të titujve; ose
 - (iv) faktin që vlera e çdo asetit bazë nuk është më e disponueshme ose e besueshme.
- f) Ekzistencën dhe shkallën e pabarazisë ndërmjet kthimit ose fitimit të pritshëm për investitorët dhe riskut të humbjes në lidhje me instrumentin financiar, depozitën e strukturuar, aktivitetin financiar ose praktikën financiare, duke marrë parasysh, në veçanti:
- (i) kostot e strukturimit të këtij instrumenti financiar, depozite të strukturuar, aktiviteti financiar ose praktike financiare dhe kosto të tjera;
 - (ii) pabarazinë në lidhje me riskun e emetuesit të mbajtur nga emetuesi; ose

- (iii) profilin risk-kthim;
- g) Kostot dhe lehtësinë me të cilën investitorët mund të shesin instrumentin financiar përkatës ose të kalojnë në një instrument tjetër financiar, ose të dalin nga një depozitë e strukturuar, duke marrë parasysh sa vijon, veçanërisht kur është e aplikueshme, në varësi të produktit që mund të jetë një instrument financiar apo një depozitë e strukturuar:
- (i) diferencën e çmimit të blerjes dhe shitjes (*bid-ask spread*);
 - (ii) frekuencën e disponueshmërisë së tregtimit;
 - (iii) madhësinë e emetimit dhe madhësinë e tregut sekondar;
 - (iv) praninë ose mungesën e mundësuesve të likuiditetit ose e krijuesve të tregut sekondar;
 - (v) veçoritë e sistemit të tregtimit; ose
 - (vi) çdo pengesë tjetër anuluar ose faktin që tërheqja e hershme nuk lejohet;
- h) çmimin dhe kostot shoqëruese të depozitës së strukturuar, instrumentit financiar, aktivitetit financiar ose praktikës financiare, duke marrë parasysh, në veçanti:
- (i) përdorimin e tarifave të fshehura ose dytësore; ose
 - (ii) tarifat që nuk pasqyrojnë nivelin e shërbimit të ofruar;
- i) Shkallën e inovacionit të një instrumenti financiar ose depozite të strukturuar, një aktivitet financiar ose praktikë financiare, duke marrë parasysh, në veçanti:
- (i) shkallën e inovacionit në lidhje me strukturën e instrumentit financiar, depozitën e strukturuar, aktivitetin financiar ose praktikën financiare, duke përfshirë përfshirjen dhe nxitjen;
 - (ii) shkallën e inovacionit në lidhje me modelin e shpërndarjes ose shtrirjen e zinxhirit të ndërmjetësimit;
 - (iii) shtrirjen e përhapjes së inovacionit, duke përfshirë faktin se instrumenti financiar, depozita e strukturuar, aktiviteti financiar ose praktika financiare është novatore për kategori të veçanta klientësh;
 - (iv) inovacionin që përfshin levën financiare;
 - (v) mungesën e transparencës së asetit /instrumentit financiar bazë; ose
 - (vi) përvojën e mëparshme të tregut me instrumente të ngjashme financiare, depozita të strukturuar ose praktika shitjeje;
- j) Praktikatat e shitjes që lidhen me instrumentin financiar ose depozitën e strukturuar, duke marrë parasysh, në veçanti:
- (i) kanalet e komunikimit dhe shpërndarjes që janë përdorur;

- (ii) informacionet, marketingun ose materiale të tjera promovuese që lidhen me investimin;
 - (iii) qëllimet e supozuara të investimit; ose
 - (iv) nëse vendimi për të blerë është vendim dytësor ose terciar pas një blerjeje të mëparshme;
- k) Situatën financiare dhe të biznesit të emetuesit të një instrumenti financiar ose depozite të strukturuar, duke marrë parasysh, në veçanti:
- (i) situatën financiare të emetuesit ose të çfarëdo garantorit; ose
 - (ii) transparencën e situatës së biznesit të emetuesit ose garantorit;
- l) Nëse ka informacione të pamjaftueshme, ose jo të besueshme, në lidhje me një instrument financiar ose depozitë të strukturuar, të ofruar qoftë nga prodhuesi ose shpërndarësi, për t'iu mundësuar pjesëmarrësve të tregut, tek të cilët synohen, marrjen e një vendimi të informuar, duke marrë parasysh natyrën dhe llojin e instrumentit financiar ose të depozitës së strukturuar;
- m) Nëse instrumenti financiar, depozita e strukturuar, aktiviteti financiar ose praktika financiare përbën një rrezik të lartë për ecurinë e transaksioneve të kryera nga pjesëmarrësit ose investitorët në tregun përkatës;
- n) Nëse aktiviteti financiar ose praktika financiare do të cenonte ndjeshëm integritetin e procesit të formimit të çmimit në tregun përkatës, në mënyrë që çmimi ose vlera e instrumentit financiar ose depozitës së strukturuar në fjalë të mos përcaktohet më sipas forcave legjitime të tregut të ofertës dhe kërkesës, ose do të ishte e tillë që pjesëmarrësit e tregut të mos mund të mbështeten më në çmimet e formuara në atë treg ose në vëllimet e tregimit si bazë për vendimet e tyre për investime;
- o) Nëse një instrument financiar, një depozitë e strukturuar, një aktivitet apo praktikë financiare do ta bënte ekonominë kombëtare të cenueshme ndaj risqeve;
- p) Nëse karakteristikat e një instrumenti financiar ose depozite të strukturuar e bëjnë atë të dyshimtë për t'u përdorur për qëllime të krimit financiar dhe, veçanërisht nëse karakteristikat mund të nxisin potencialisht përdorimin e instrumentit financiar ose depozitës së strukturuar për:
- (i) çdo mashtrim ose pandershmëri;
 - (ii) sjellje të gabuar ose keqpërdorim informacioni në lidhje me një treg financiar;
 - (iii) përpunimin e të ardhurave nga krimi;
 - (iv) financimin e terrorizmit; ose
 - (v) lehtësimin e pastrimit të parave.

- q) Nëse një aktivitet financiar ose një praktikë financiare përbën një risk veçanërisht të lartë për qëndrueshmërinë ose funksionimin e qetë të tregjeve dhe infrastrukturës së tyre;
- r) Nëse një instrument financiar, depozitë e strukturuar, aktivitet financiar ose praktikë financiare mund të çojë në një pabarazi të konsiderueshme dhe artificiale midis çmimeve të një derivativi dhe atyre në tregun bazë;
- s) Nëse instrumenti financiar, depozita e strukturuar, aktiviteti financiar ose praktika financiare përbën një risk të lartë përçarjeje për institucionet financiare që konsiderohen të rëndësishme për sistemin financiar, veçanërisht duke marrë në konsideratë strategjinë e mbrojtjes së ndjekur nga institucionet financiare në lidhje me emetimin e depozitës së strukturuar, duke përfshirë çmimin e gabuar të garancisë së kapitalit në maturim ose risqet reputacionale që sjell depozita e strukturuar ose praktika ose aktiviteti për institucionet financiare;
- t) Rëndësinë e shpërndarjes së instrumentit financiar ose depozitës së strukturuar si burim financimi për emetuesin ose institucionet financiare;
- u) Nëse një instrument financiar, një depozitë e strukturuar, një aktivitet financiar ose një praktikë financiare paraqet rreziqe të veçanta për tregun ose infrastrukturën e sistemeve të pagesave, duke përfshirë sistemet e tregimit, klerimit dhe shlyerjes; ose
- v) Nëse një instrument financiar, depozitë e strukturuar, aktivitet financiar ose praktikë financiare do të kërcënonte besimin e investitorëve në sistemin financiar.

Neni 28

Informacion për pozicionet tregtare

1. Në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje, Autoriteti, kur plotësohen të dyja kushtet në pikën 2 të këtij neni, merr një ose më shumë nga masat e mëposhtme:
 - a) Kërkon nga çdo person të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me madhësinë dhe qëllimin e një pozicioni ose ekspozimi të lidhur nëpërmjet një derivativi;
 - b) Pas analizimit të informacionit të marrë në përputhje me shkronjën a), kërkon që çdo person i tillë të reduktojë madhësinë ose të eliminojë pozicionin ose ekspozimin;
 - c) Si mjet i fundit, kufizon aftësinë e një personi për t'u angazhuar në një derivativ mallrash.
2. Autoriteti merr vendim sipas pikës 1 të këtij neni vetëm nëse masat e renditura në këtë pikë i adresohen një kërcënimi për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve financiare, duke përfshirë tregjet e derivativëve të mallrave, ose stabilitetin e të gjithë ose të një pjese të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë.
3. Me marrjen e masave të referuara në pikën 1 të këtij neni, Autoriteti siguron që masa:
 - a) Adreson në mënyrë të konsiderueshme kërcënimin për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve financiare, duke përfshirë tregjet e derivativëve të mallrave, ose stabilitetin e të gjithë ose një pjese të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë ose

përmirëson ndjeshëm aftësinë e autoriteteve kompetente për të monitoruar kërcënimin e matur;

- b) Nuk krijon rrezik për arbitrazh rregullator;
 - c) Nuk ka asnjë nga efektet e dëmshme të mëposhtme mbi efikasitetin e tregjeve financiare që është në disproporcion me përfitimet e masës: si ulja e likuiditetit në ato tregje, kufizimi i kushteve për reduktimin e risqeve të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin tregtar të një kundërpale jo-financiare, ose krijimin e pasigurisë për pjesëmarrësit në treg.
4. Kur përcaktohet ekzistenca e një kërcënimi për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve financiare, duke përfshirë tregjet e derivativëve të mallrave ose stabilitetin e të gjithë ose një pjese të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë të referuara në pikën 2 të këtij neni, merren në konsideratë kriteret e specifikuar në nenin 29 të kësaj rregulloreje.
 5. Autoriteti publikon në faqen e tij të internetit njoftimin për çdo vendim për vendosjen ose rinovimin e çdo mase të referuar në pikën 1, shkronja c) të këtij neni. Njoftimi përfshin detaje për personin në fjalë, instrumentet financiare të aplikueshme, masat sasiore përkatëse, si: madhësia maksimale e një pozicioni që mund të zërë personi në fjalë dhe arsyet për këtë.
 6. Masa e përmendur në pikën 1, shkronja c) të këtij neni hyn në fuqi kur njoftimi të publikohet ose pas publikimit të tij, në një kohë të përcaktuar në njoftim, dhe do të zbatohet vetëm për një transaksion të kryer pasi masa të hyjë në fuqi.
 7. Pikat 2 deri në 6 të këtij neni zbatohen edhe për rinovimin e masave.

Neni 29

Kriteret dhe faktorët që duhet të merren parasysh nga Autoriteti kur vlerëson informacionin për pozicionet tregtare

1. Për qëllimet e nenit 28, pika 2 të kësaj rregulloreje, kriteret dhe faktorët që përcaktojnë ekzistencën e një kërcënimi për funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve financiare, duke përfshirë tregjet e derivativëve të mallrave, ose stabilitetin e të gjithë ose të një pjese të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë janë si më poshtë:
 - a) Ekzistenca e problemeve serioze financiare, monetare ose buxhetore që mund të çojnë në paqëndrueshmërinë financiare të Republikës së Shqipërisë ose të një institucioni financiar që konsiderohet i rëndësishëm për sistemin financiar, duke përfshirë bankat, shoqëritë e sigurimeve, ofruesit e infrastrukturës së tregut dhe shoqëritë për administrimin e aseteve që ushtrojnë veprimtarinë brenda Republikës së Shqipërisë, duke marrë parasysh se këto probleme mund të rrezikojnë funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve financiare ose stabilitetin e sistemit financiar brenda Republikës së Shqipërisë;
 - b) Një ndryshim i vlerësimit kreditor ose faliment nga Republika e Shqipërisë ose një banke ose një institucion tjetër financiar që konsiderohet i rëndësishëm për sistemin financiar, si shoqëritë e sigurimeve, ofruesit e infrastrukturës së tregut dhe shoqëritë për administrimin e aseteve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë brenda Republikës së Shqipërisë, i cili shkakton ose mund të pritet të shkaktojë pasiguri të madhe në lidhje me aftësinë paguese të tyre;

- c) Presionet/vëllimet të konsiderueshme shitjeje ose luhatshmëri e pazakontë që shkaktojnë spirale të rëndësishme në rënie në çdo instrument financiar të lidhur me çdo bankë ose institucione të tjera financiare që konsiderohen të rëndësishme për sistemin financiar, si shoqëritë e sigurimeve, ofruesit e infrastrukturës së tregut dhe shoqëritë për administrimin e aseteve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë brenda Republikës së Shqipërisë dhe emetuesit sovranë;
 - d) Çdo dëmtim i strukturave fizike të emetuesve të rëndësishëm financiarë, infrastrukturave të tregut, sistemeve të klerimit dhe shlyerjes ose autoriteteve kompetente që mund të ndikojë negativisht dhe në mënyrë të konsiderueshme në tregje, veçanërisht kur një dëm i tillë rezulton nga një fatkeqësi natyrore ose një sulm terrorist;
 - e) Një ndërprerje në çdo sistem pagese ose proces shlyerjeje, veçanërisht kur lidhet me operacionet ndërbankare, që shkakton ose mund të shkaktojë mosrealizime ose vonesa të konsiderueshme pagesash ose shlyerjesh brenda sistemeve të pagesave të Republikës së Shqipërisë, sidomos kur këto mund të çojnë në përhapjen e stresit financiar ose ekonomik në një institucion krediti ose institucione të tjera financiare që konsiderohen të rëndësishme për sistemin financiar global, si kompanitë e sigurimeve, ofruesit e infrastrukturës së tregut dhe kompanitë për administrimin e aseteve;
 - f) Paaftësia e një vendi tregtimi për të ushtruar kompetencat e veta për menaxhimin e pozicionit për shkak të një ngjarjeje të vazhdimësisë së biznesit.
2. Për qëllim të nenit 28, pika 1, shkronja b) të kësaj rregulloreje, kriteret dhe faktorët që përcaktojnë reduktimin e duhur të një pozicioni ose ekspozimi janë si më poshtë:
- a) Natyra e mbajtësit të pozicionit, duke përfshirë prodhuesit, konsumatorët ose institucionin financiar;
 - b) Maturimi i instrumentit financiar;
 - c) Madhësia e pozicionit në lidhje me madhësinë e tregut përkatës të derivativëve të mallrave;
 - d) Lloji i pozicionit (long, short);
 - e) Qëllimi i pozicionit, veçanërisht nëse pozicioni shërben për qëllime mbrojtëse/transferimi të riskut ose nëse mbahet për ekspozim financiar;
 - f) Përvoja e një mbajtësi të pozicionit në mbajtjen e pozicioneve të një madhësie të caktuar;
 - g) Pozicione të tjera që mbahen nga personi në tregun bazë ose në maturime të ndryshme të të njëjtit derivativ;
 - h) Likuiditeti i tregut dhe ndikimi i masës tek pjesëmarrësit e tjerë të tregut;
 - i) Mënyra e dorëzimit.
3. Për qëllimet e nenit 28 pika 3, shkronja b) të kësaj rregulloreje, kriteret që specifikojnë situatat ku mund të lindë rreziku i arbitrazhit rregullator janë si më poshtë:

- a) Nëse e njëjta kontratë tregtohet në një vend tjetër tregtimi ose në tregun mbi banak (OTC) ;
- b) Nëse një kontratë në thelb ekuivalente tregtohet në një vend të ndryshëm ose në tregun mbi banak (OTC) ;
- c) efektet e vendimit mbi tregjet dhe pjesëmarrësit që nuk i nënshtrohen kompetencave e pozicionit menaxhues të Autoritetit; dhe
- d) Efekti i mundshëm në funksionimin e rregullt dhe integritetin e tregjeve në mungesë të veprimit të Autoritetit.

KREU VII DISPOZITA E FUNDIT

Neni 30

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në 1 janar 2024.

SHTOJCA I – FORMA DHE PËRMBAJTJA E APLIKIMIT

[Identiteti dhe detajet e kontaktit të aplikantit]

[Aplikim për vënien në funksion të një burse/operatori tregu që vë në funksion veprimtarinë e një treg të rregulluar]

[DATA E APLIKIMIT]

PËRMBLEDHJE

DEKLARATA E APLIKANTIT

Me besimin tonë maksimal dhe në bazë të të gjitha informacioneve dhe të dhënave të parashtruara në aplikim, ne deklarojmë se të gjitha informacionet dhe të dhënat e paraqitura këtu janë të sakta dhe korrekte dhe se asnjë informacion ose e dhënë që ndikon në saktësinë dhe plotësinë e informacionit, nuk është hequr,

Nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i aplikantit]

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONET QË PËRMBAN APLIKIMI

Aplikanti pranon përgjegjësinë për informacionet dhe të dhënat e përfshira në këtë aplikim. Informacionet janë në përputhje me faktet dhe nuk lënë jashtë asnjë informacion që do të cenonte rëndësinë e tij. Kur përdoren informacione nga burime të palëve të treta, këto informacione riprodhohen me saktësi.

SEKSIONI 1 – Informacionet kryesore për aplikantin

Zëri 1	Emri dhe forma ligjore e aplikantit
Zëri 1.1.	Rruga, numri i rrugës, kodi postar, qyteti dhe shteti
Zëri 1.2.	Ligji sipas të cilit vepron aplikanti
Zëri 1.3.	Vendi i themelimit të aplikantit

SEKSIONI 2 – Informacione të dhëna nga aplikanti

Operatori përkatës për të cilin është dorëzuar aplikimi	Pika përkatëse e kësaj rregulloreje	Numri i referencës së dokumentit	Titulli i dokumentit	Kapitulli ose seksioni ose faqja e dokumentit ku jepet informacioni ose arsyet pse informacioni nuk është dhënë

SHTOJCA II

KARAKTERISTIKAT E KLASAVE TË NDRYSHME TË INSTRUMENTEVE FINANCIARE QË DUHEN MARRË PARASYSH NGA TREGU I RREGULLUAR KUR VLERËSOHET NËSE INSTRUMENTI FINANCIAR EMETOHET NË PËRPUTHJE ME NENIN 18, PIKA 1, TË KËSAJ RREGULLOREJE PËR PRANIMIN NË TREGTIM NË SEGMENTE TË NDRYSHME TË TREGUT

Neni 1

Tituj të transferueshëm - lirisht të negociueshëm

1. Titujt e transferueshëm konsiderohen lirisht të negociueshëm nëse ato mund të tregtohen ndërmjet palëve në një transaksion dhe më pas të transferohen pa kufizime dhe nëse të gjithë titujt brenda së njëjtës klasë si titujt në fjalë janë të këmbyeshëm.
2. Titujt e transferueshëm të cilët i nënshtrohen një kufizimi në transferim nuk konsiderohen si lirisht të negociueshëm në përputhje me pikën 1 të këtij neni, përveçse nëse ky kufizim nuk ka gjasa të cenojë tregun e rregulluar. Titujt e transferueshëm që nuk janë paguar plotësisht mund të konsiderohen si lirisht të negociueshëm nëse janë marrë masa për të siguruar që negociueshmëria e këtyre titujve nuk është e kufizuar dhe se janë në dispozicion të publikut informacionet e duhura në lidhje me faktin se titujt nuk janë paguar plotësisht dhe implikimet e këtij fakti për aksionarët.

Neni 2

Titujt e transferueshëm - tregtimi i drejtë, i rregullt dhe efikas

1. Kur vlerësohet nëse një titull i transferueshëm mund të tregtohet në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase, një treg i rregulluar merr parasysh informacionin e kërkuar sipas Rregullores nr. 4 “Për formën dhe përmbajtjen e Prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe/ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar” ose informacione që vihen në dispozicion publikisht si:
 - a) Historiku i informacioneve financiare;
 - b) Informacione për emetuesin;
 - c) Informacione që ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të biznesit.
2. Përveç pikës 1 të këtij neni, kur vlerësohet nëse një aksion mund të tregtohet në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase, tregu i rregulluar merr parasysh shpërndarjen e atyre aksioneve për publikun.
3. Kur vlerësohet nëse një titull i transferueshëm mund të tregtohet në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase, tregu i rregulluar merr parasysh, në varësi të natyrës së titullit që pranohet, nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:
 - a) Kushtet e titullit janë të qarta dhe të paqarta dhe lejojnë një korrelacion midis çmimit të titullit dhe çmimit ose masës tjetër të vlerës bazë;

- b) Çmimi ose masa tjetër e vlerës bazë është e besueshme dhe e disponueshme për publikun;
- c) Ka informacione të mjaftueshme të disponueshme publikisht të nevojshëm për të vlerësuar titullin;
- d) Procedurat për përcaktimin e çmimit të shlyerjes së titullit sigurojnë se ky çmim pasqyron siç duhet çmimin ose masa të tjera të vlerës bazë;
- e) Kur shlyerja e titullit kërkon ose parashikon mundësinë e dorëzimit të një titulli ose aseti bazë në vend të shlyerjes me para, ekzistojnë procedura të përshtatshme shlyerjeje dhe shpërndarjeje për atë bazë, si dhe marrëveshje të përshtatshme për të marrë informacionin përkatës në lidhje me të.

Neni 3

Titujt e transferueshëm - listim zyrtar

Titulli i transferueshëm që është i listuar zyrtarisht dhe listimi i të cilit nuk është pezulluar në një treg të rregulluar, do të konsiderohet se është lirisht i negociueshëm dhe mund të tregtohet në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase.

Neni 4

Kuotat dhe aksionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive

1. Një treg i rregulluar, kur pranon për tregtim kuota ose aksione të një sipërmarrjeje investimi kolektiv, duhet të sigurojë që ato kuota të plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin në fuqi “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.
2. Gjithashtu, kur vlerësohet nëse kuotat ose aksionet në një sipërmarrje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur mund të tregtohen në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase, një treg i rregulluar duhet të marrë parasysh sa vijon:
 - a) Shpërndarjen e atyre kuotave ose aksioneve për publikun;
 - b) Nëse ka procedura të përshtatshme për krijimin e tregut, ose nëse shoqëria administruese ofron procedura të përshtatshme alternative për investitorët për të shlyer kuotat ose aksionet;
 - c) Në rastin e fondeve të tregtueshme në bursë, nëse përveç marrëveshjeve të tregut, ofrohen edhe marrëveshje alternative të përshtatshme për investitorët për të shlyer kuotat ose aksionet, të paktën në rastet kur vlera e kuotave ose aksioneve ndryshon ndjeshëm nga vlera neto e aseteve;
 - d) Nëse vlera e kuotave ose aksioneve bëhet mjaftueshëm transparente për investitorët me anë të publikimit periodik të vlerës neto të aseteve.
3. Kur vlerësohet nëse kuotat ose aksionet në një sipërmarrje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të mbyllur mund të tregtohen në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase, një treg i rregulluar duhet të marrë parasysh sa vijon:

- a) Shpërndarjen e atyre kuotave ose aksioneve për publikun;
- b) Nëse vlera e kuotave ose aksioneve bëhet mjaftueshëm transparente për investitorët, qoftë nëpërmjet publikimit të informacionit mbi strategjinë e investimit të fondit ose nëpërmjet publikimit periodik të vlerës neto të aseteve.

Neni 5 Derivativët

Kur vlerësohet nëse një derivativ mund të tregtohet në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase, një treg i rregulluar duhet të verifikojë plotësimin e kushteve të mëposhtme:

- a) Kushtet e kontratës që krijon instrumentin financiar janë të qarta dhe jo të dyshimta e mundësojnë një korrelacion midis çmimit të instrumentit financiar dhe çmimit ose masës tjetër të vlerës bazë;
- b) Çmimi ose masa tjetër e vlerësimit të bazë është e besueshme dhe e disponueshme për publikun;
- c) Është i disponueshëm publikisht informacioni i mjaftueshëm për të vlerësuar derivativin;
- d) Procedurat për përcaktimin e çmimit të shlyerjes së kontratës janë të tilla që çmimi pasqyron siç duhet çmimin ose masat e tjera të vlerës të instrumentit /titullit bazë;
- e) Kur shlyerja e derivativit kërkon ose parashikon mundësinë e dorëzimit të një titulli ose titulli bazë në vend të shlyerjes me para, ekzistojnë procedura të përshtatshme për t'u mundësuar pjesëmarrësve të tregut të marrin informacionet përkatëse në lidhje me atë titull bazë, si dhe shlyerjen e përshtatshme dhe procedurat e dorëzimit për titullin bazë.

Neni 6 Kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë

Çdo kuotë e lejuar e çlirimit të gazrave serrë është i pranueshëm për t'u tregtuar në një treg të rregulluar pa kritere të mëtejshme.

SHTOJCA III

TRANSPARENCA PËR OPERATORËT E TREGUT

KREU 1

Transparenca për instrumentet e kapitalit

Neni 1

Kriteret e transparencës para tregtimit për tregjet e rregulluara në lidhje me aksionet, dëftesat e depozitarit, fondet e tregtuara në bursë (ETF-të), certifikatat dhe instrumentet e tjera financiare të ngjashme

1. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë publike gamën e çmimeve aktuale të blerjes dhe shitjes dhe thellësinë e tregut (“Market Depth”), në ato çmime që reklamohen nëpërmjet sistemeve të tyre për aksionet dëftesat e depozitarit, fondet e tregtuara në bursë (ETF-të), certifikatat dhe instrumente të ngjashme financiare që tregtohen në një treg të rregulluar.

Ky kriter zbatohet gjithashtu për treguesit e interesave të zbatueshme. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë atë informacion të disponueshëm për publikun në mënyrë të vazhdueshme gjatë orëve normale të tregtimit.

2. Kriteret e transparencës të referuara në pikën 1 të këtij neni kalibrohen për lloje të ndryshme sistemesh tregtimi, duke përfshirë sistemet e librit të urdhrave (order book), kuotave të përcaktuara nga krijuesit e tregut/dealerave, sistemet hibride dhe periodike të ankandeve të, nëse janë të zbatueshme.
3. Informacionet nga pika 1 i këtij neni bëhen publike në përputhje me llojin e sistemeve të tregtimit me të cilat ato operojnë, siç është përcaktuar në tabelën 1 të kësaj Shtojce.

Neni 2

Përrjashtimet për instrumentet e kapitalit

1. Autoriteti mund të përjashtojë nga detyrimi operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar për të bërë publike informacionet e referuara në nenin 1, pika 1 të kësaj Shtojce për:

- a) Sistemet e përputhjes së urdhrave bazuar në një metodologji tregtimi me anë të së cilës çmimi i instrumentit financiar të referuar në nenin 1, pika 1 të kësaj Shtojce rrjedh nga tregu i rregulluar ku ai instrument financiar është pranuar për herë të parë në treg, ku ai çmim reference publikohet gjerësisht dhe konsiderohet nga pjesëmarrësit e tregut si një çmim referimi i besueshëm;

Përdorimi i vazhdueshëm i këtij përjashtimi i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Shtojce.

- b) Sistemet që zyrtarizojnë transaksionet e negociuara të cilat:

- (i) ndodhen brenda shpërndarjes së ponderuar sipas vëllimit, siç pasqyrohet në librin e urdhrave ose në kuotimet e krijuesve të tregut, të rregulluar që operojnë atë sistem, në varësi të kushteve të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Shtojce;
 - (ii) në një aksion jo likuid, dëftesë depozitari, fond i tregtuar në bursë (ETF), certifikatë, ose instrument tjetër financiar të ngjashëm që nuk përfshihet në kuptimin e një tregu likuid dhe trajtohen brenda një përqindjeje të një çmimi të përshtatshëm reference të përcaktuar paraprakisht nga operatori i tregut të rregulluar ; ose
 - (iii) janë subjekt i kushteve të ndryshme nga çmimi aktual i tregut të atij instrumenti financiar.
- c) Urdhrat që janë në shkallë të madhe krahasuar me madhësinë normale të tregut;
- d) Urdhrat që mbahen në një objekt për menaxhimin e urdhrave të tregut të rregulluar në pritje për t'u bërë të ditura.
2. Çmimi i referencës i referuar në pikën 1, shkronja a) e këtij neni përcaktohet duke marrë:
- a) Pikën e mesit brenda çmimeve aktuale të blerjes dhe shitjes së tregut të rregulluar ku ai instrument financiar është pranuar për herë të parë; ose
 - b) Çmimin e hapjes ose të mbylljes së sesionit përkatës të tregtimit kur çmimi i referuar në shkronjën a) të kësaj pike nuk është i disponueshëm,, çmimi i hapjes ose i mbylljes në sesionin përkatës të tregtimit
- Urdhrat do t'i referohen vetëm çmimit të referuar në shkronjën b) të kësaj pike jashtë fazës së tregtimit të vazhdueshëm të sesionit përkatës të tregtimit.
3. Kur tregjet e rregulluara operojnë sisteme që formalizojnë transaksionet e negociuara në përputhje me pikën 1, shkronja b) nënpika i) të këtij neni:
- a) Këto transaksione kryhen në përputhje me rregullat e tregut të rregulluar;
 - b) Tregu i rregulluar siguron që ka në zbatim masat, sistemet dhe procedurat për të parandaluar dhe zbuluar abuzimin e tregut ose tentativën për abuzim të tregut në lidhje me transaksione të tilla të negociuara në përputhje me rregulloren për “Ndalimin e Abuzimit me tregun”;
 - c) tregu i rregulluar duhet të krijojë, mirëmbajë dhe zbatojë sisteme për të zbuluar çdo përpjekje për të përdorur përjashtimet për të anashkaluar kriteret e tjera të kësaj rregulloreje dhe për të raportuar përpjekjet tek Autoriteti.
4. Kur Autoriteti vendos një përjashtim në përputhje me pikën 1, shkronja b) nënpikat (i), (ii) ose (iii) të këtij neni, Autoriteti monitoron përdorimin e përjashtimeve nga tregu i rregulluar për të siguruar respektimin e kushteve. Një transaksion i negociuar në aksione, dëftesa depozitari, fond i tregtuar në bursë (ETF), certifikata, ose instrumente të tjera financiare të ngjashme konsiderohet të jetë një transaksion i negociuar privatisht, por i raportuar sipas rregullave të një vendi tregtimi dhe ku zbatohet cilado nga rrethanat e mëposhtme:

- a) Dy anëtarë ose pjesëmarrës të atij tregu të rregulluar janë të përfshirë në cilindo nga kapacitetet e mëposhtme:
 - (i) njëri vepron për llogari të vet kur tjetri vepron në emër të një klienti;
 - (ii) të dy veprojnë për llogari të vet;
 - (iii) të dy veprojnë në emër të klientit.
 - b) Njëri anëtar ose pjesëmarrës i tregut të rregulluar është një nga sa vijon:
 - (i) vepron në emër të blerësit dhe shitësit;
 - (ii) vepron për llogari të vet kundrejt urdhrit të një klienti.
5. Transaksioni i negociuar në aksione, dëftesa depozitari, fond i treguar në bursë (ETF), certifikata dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme do t'i nënshtrohet kushteve të ndryshme nga çmimi aktual i tregut të instrumentit financiar kur zbatohet cilado nga rrethanat e mëposhtme:
- a) Transaksioni kryhet duke iu referuar një çmimi që llogaritet në instanca të shumta kohore sipas një treguesi referencë të caktuar, duke përfshirë transaksionet e kryera duke iu referuar një çmimi mesatar të ponderuar në vëllim ose një çmimi mesatar të ponderuar në kohë;
 - b) Transaksioni është pjesë e një tregtimi portofoli;
 - c) Transaksioni është i kushtëzuar nga blerja, shitja, krijimi ose shlyerja e një kontrate derivative ose instrumenti tjetër financiar ku të gjithë përbërësit e tregtimit janë menduar të ekzekutohen si një lot i vetëm;
 - d) Transaksioni është një transaksion “heqje dorë” ose një transaksion “dorëzimi”;
 - e) Transaksioni ka si qëllim transferimin e instrumenteve financiare si kolateral në transaksionet dypalëshe ose në kontekstin e një marzhi të CCP-së ose kriterëve të kolateralit ose si pjesë e procesit të menaxhimit të parazgjedhur të një CCP-je;
 - f) Transaksioni rezulton në dorëzimin e instrumenteve financiare në kontekstin e ushtrimit të obligacioneve të konvertueshme, opsioneve, garancive të mbuluara ose derivativëve të tjerë financiarë të ngjashëm;
 - g) Transaksioni është një transaksion financimi i titujve.
6. Autoriteti mund të tërheqë përjashtimin nga pika 1 e këtij neni nëse vëren se përjashtimi po përdoret në një mënyrë që devijon nga qëllimi i tij fillestar ose nëse beson se po përdoret për të anashkaluar kërkesat e përcaktuara në këtë nen.

Neni 3

Karakteristika specifike të transaksioneve të negociuara sipas nenit 2, pika 2, shkronja b) e kësaj Shtojce

Transaksioni i negociuar në aksione, dëftesa depozitari, fond i tregtuar në bursë (ETF), certifikata dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme konsiderohet të jetë një

transaksion i cili negociohet privatisht, por raportohet sipas rregullave të një tregu të rregulluar dhe ku zbatohet cilado nga rrethanat e mëposhtme:

- a) Dy anëtarë ose pjesëmarrës të atij vendi tregtimi janë të përfshirë në cilindo nga kapacitetet e mëposhtme:
 - (i) njëri vepron për llogari të vet kur tjetri vepron në emër të një klienti;
 - (ii) të dy veprojnë për llogari të vet;
 - (iii) të dy veprojnë në emër të klientit;
- b) Njëri anëtar ose pjesëmarrës i atij vendi tregtimi është një nga sa vijon:
 - (i) vepron në emër të blerësit dhe shitësit;
 - (ii) vepron për llogari të vet kundrejt urdhrin të një klienti.

Neni 4

Transaksionet e negociuara që u nënshtrohen kushteve të ndryshme nga çmimi aktual i tregut në përputhje me nenin 2 pika 1, shkronja b), e kësaj Shtojce

Transaksioni i negociuar në aksione, dëftesa depozitari, fond i tregtuar në bursë (ETF), certifikata dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme do t'i nënshtrohet kushteve të ndryshme nga çmimi aktual i tregut të instrumentit financiar ku zbatohet cilado nga rrethanat e mëposhtme:

- a) Transaksioni kryhet duke iu referuar një çmimi që llogaritet në instanca të shumta kohore sipas një treguesi referencë të caktuar, duke përfshirë transaksionet e kryera duke iu referuar një çmimi mesatar të ponderuar në vëllim ose një çmimi mesatar të ponderuar në kohë;
- b) Transaksioni është pjesë e një tregtimi portofoli;
- c) Transaksioni është i kushtëzuar nga blerja, shitja, krijimi ose shlyerja e një kontrate derivative ose instrumenti tjetër financiar ku të gjithë përbërësit e tregtimit janë menduar të ekzekutohen si një lot i vetëm;
- d) Transaksioni është një transaksion “heqje dorë” ose një transaksion “dorëzim”;
- e) Transaksioni ka si qëllim transferimin e instrumenteve financiare si kolateral në transaksionet dypalëshe ose në kontekstin e një marzhi të CCP-së ose kritereve të kolateralit ose si pjesë e procesit të menaxhimit të parazgjedhur të një CCP-je;
- f) Transaksioni rezulton në dorëzimin e instrumenteve financiare në kontekstin e ushtrimit të obligacioneve të konvertueshme, opsioneve, garancive të mbuluara ose derivativëve të tjerë financiarë të ngjashëm;
- g) Transaksioni është një transaksion financimi i titujve;

- h) Çdo transaksion tjetër ekuivalent me një nga ato të përshkruara nga shkronja a) deri në shkronjën g), në atë që varet nga karakteristikat teknike që nuk kanë lidhje me vlerësimin aktual të tregut të instrumentit financiar të tregtuar.

Neni 5

Urdhrat që janë në shkallë të madhe në përputhje me nenin 2, pika 1, shkronja c) të kësaj Shtojce

1. Urdhri në lidhje me një aksion, dëftesë depozitari, certifikatë ose instrument tjetër financiar të ngjashëm konsiderohet të jetë në shkallë të madhe, kur urdhri të jetë i barabartë ose më i madh sesa madhësia/volumi minimale e urdhrave të përcaktuar/a në tabelat 2 dhe 3 të kësaj Shtojce.
2. Urdhri në lidhje me një fond të tregtuar në bursë (ETF) do të konsiderohet të jetë në shkallë të madhe, kur urdhri është i barabartë ose më i madh sesa 114,000,000 Lekë.
3. Me qëllim përcaktimin e urdhrave që janë në shkallë/volum të madhe, Autoriteti llogarit, në përputhje me pikën 4 të këtij neni, qarkullimin mesatar ditor në lidhje me aksionet, dëftesat e depozitarit, certifikatat dhe instrumentet e tjera financiare të ngjashme që tregtohen në një treg të rregulluar.
4. Llogaritja e referuar në pikën 3 të këtij neni duhet të ketë këto karakteristika:
 - a) Të përfshijë transaksionet e kryera në Republikën e Shqipërisë në lidhje me instrumentin financiar që tregtohet në një treg të rregulluar;
 - b) Të mbulojë periudhën që fillon më 1 janar të vitit kalendarik paraardhës dhe përfundon më 31 dhjetor të vitit kalendarik paraardhës ose, sipas rastit, atë pjesë të vitit kalendarik gjatë të cilit instrumenti financiar është pranuar për tregtim ose është tregtuar në një treg të rregulluar.

Pikat 3 dhe 4 nuk do të zbatohen për aksionet, dëftesat e depozitarit, certifikatat dhe instrumentet e tjera të ngjashme financiare të pranuar për herë të parë për tregtim ose të tregtuara për herë të parë në një treg të rregulluar katër javë ose më pak përpara fundit të vitit kalendarik paraardhës.

5. Me përjashtim të rasteve kur çmimi ose kushtet e tjera përkatëse për ekzekutimin e një urdhri janë ndryshuar, përjashtimi nga neni 2, pika 1 i kësaj Shtojce do të vazhdojë të zbatohet në lidhje me një urdhër që është në shkallë të madhe kur regjistrohet në një libër urdhrash, por që, pas ekzekutimit të pjesshëm, bie nën kufirin e zbatueshëm për atë instrument financiar, siç përcaktohet në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni.
6. Përpara se një aksion, dëftesë depozitari, certifikatë ose instrument tjetër financiar i ngjashëm të tregtohet për herë të parë në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti vlerëson xhiron mesatare ditore për atë instrument financiar duke marrë parasysh çdo histori të mëparshme tregtimi të atij instrumenti financiar dhe të instrumenteve të tjera financiare që konsiderohen se kanë karakteristika të ngjashme dhe nëse është e mundur siguron publikimin e atij vlerësimi..
7. Qarkullimi mesatar ditor i referuar në pikën 6 të këtij neni përdoret për llogaritjen e urdhrave në shkallë të madhe gjatë një periudhe gjashtë javore pas datës kur aksioni, dëftesa e

depozitarit, certifikata ose instrumenti i ngjashëm financiar është pranuar për tregtim ose është tregtuar për here të parë në një treg të rregulluar.

8. Autoriteti llogarit dhe siguron publikimin e qarkullimit mesatar ditor në bazë të katër javëve të para të tregtimit përpara përfundimit të periudhës gjashtëjavore të referuar në pikën 7 të këtij neni.
9. Qarkullimi mesatar ditor i referuar në pikës 8 të këtij neni përdoret për llogaritjen e urdhrave në shkallë të madhe dhe derisa të aplikohet qarkullimi mesatar ditor i llogaritur në përputhje me pikën 3 të këtij neni.
10. Për qëllimet e këtij neni, qarkullimi mesatar ditor llogaritet duke pjesëtuar xhiron totale për një instrument financiar të caktuar me numrin e ditëve të tregtimit në periudhën e marrë në konsideratë.

Numri i ditëve të tregtimit në periudhën e marrë në konsideratë është numri i ditëve të tregtimit në tregun më relevant për sa i përket likuiditetit për atë instrument financiar, siç përcaktohet në përputhje me nenin 4.

Neni 6

Lloji dhe madhësia minimale e urdhrave të mbajtur/a në një sistem të menaxhimit të urdhrave në përputhje me nenin 2 pika 1, shkronja d) të kësaj Shtojce

1. Lloji i urdhrit të mbajtur në një sistem të menaxhimit të urdhrave të një tregu të rregulluar në pritje të shfaqjes për të cilin mund të ketë përjashtim nga detyrimet e transparencës para tregtimit është një urdhër që:
 - a) Synohet t'i shfaqet librit të urdhrave që operohet nga tregu i rregulluar dhe kushtëzohet nga kushtet objektive që janë të paracaktuara nga protokollin e sistemit;
 - b) Nuk mund të ndërveprojë me interesa të tjera tregtare përpara se të shfaqet për librin e urdhrave që operohet nga tregu i rregulluar;
 - c) Pasi të shfaqet për librin e urdhrave, ndërvepron me urdhrat e tjerë/a në përputhje me rregullat e zbatueshme për urdhrat e këtij lloji në kohën e shfaqjes.
2. Urdhrat që mbahen në një sistem të menaxhimit të urdhrave të një tregu të rregulluar në pritje të shfaqjes, për të cilat mund të ketë përjashtim nga detyrimet e transparencës para tregtimit, në pikën e hyrjes dhe pas çdo ndryshimi, kanë një nga madhësitë e mëposhtme:
 - a) Në rastin e një urdhri rezervë, një madhësi që është më e madhe ose e barabartë me 1,140,000 Lekë;
 - b) Për të gjithë urdhrat e tjerë/a, një madhësi që është më e madhe ose e barabartë me sasinë minimale të tregtueshme të vendosur paraprakisht nga operatori i sistemit sipas rregullave dhe protokolleve të tij.
3. Urdhri rezervë i/e referuar në pikën 2, shkronja a) të këtij neni konsiderohet një urdhër me kufi që përbëhet nga një urdhër i/e shfaqur në lidhje me një pjesë të një sasive dhe një urdhër i pashfaqur në lidhje me pjesën e mbetur të sasisë ku sasia e pashfaqur mund të ekzekutohet vetëm pas lëshimit të saj për librin e urdhrave si një urdhër i ri i shfaqur.

Neni 7

Mekanizmi i kufirit maksimal të vëllimit të tregtimit

1. Për të siguruar që përdorimi i përjashtimit, i parashikuar në nenin 2, pika 1, shkronja a) të kësaj shtojce dhe shkronja b) nënpika (i) të kësaj Shtojce, të mos dëmtojë në mënyrë të padrejtë formimin e çmimit, tregtimi sipas këtyre përjashtimeve është i kufizuar si më poshtë:
 - a) Përqindja e tregtimit të një instrumenti financiar të realizuar në një treg të rregulluar sipas këtyre përjashtimeve do të kufizohet në 4% të vëllimit total të tregtimit në atë instrument financiar në tregjet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë gjatë 12 muajve të mëparshëm;
 - b) Tregtimi i përgjithshëm në një instrument financiar të realizuar sipas këtyre përjashtimeve do të kufizohet në 8% të vëllimit total të tregtimit në atë instrument financiar në të gjitha vendet e tregtimit në Republikën e Shqipërisë gjatë 12 muajve të mëparshëm.

Ky mekanizëm i kufirit të vëllimit nuk do të zbatohet për transaksionet e negociuara të cilat janë në një aksion, dëftesë depozitari, fond i tregtuar në bursë (ETF), certifikatë ose instrument tjetër financiar të ngjashëm për të cilin nuk ka një treg likuid dhe tregtohen brenda një përqindjeje të një çmimi reference të përshtatshëm siç referohet në nenin 2, pika 1, shkronja b) nënpika (ii) të kësaj Shtojce ose për transaksionet e negociuara që janë subjekt i kushteve të ndryshme nga çmimi aktual i tregut të atij instrumenti financiar siç referohet në nenin 2, pika 1, shkronja b) nënpika (iii) të kësaj Shtojce.
2. Kur përqindja e tregtimit të një instrumenti financiar të realizuar në një treg të rregulluar sipas përjashtimeve ka tejkalluar kufirin e referuar në pikën 1, shkronja a) të këtij neni, Autoriteti pezullon për një periudhë gjashtë mujore përdorimin e tyre brenda dy ditësh pune në atë treg të rregulluar në atë instrument financiar bazuar në të dhënat e publikuara nga Autoriteti referuar në pikën 4 të këtij neni.
3. Kur përqindja e tregtimit të një instrumenti financiar të realizuar në të gjitha tregjet e rregulluara në të gjithë Republikën e Shqipërisë në bazë të këtyre përjashtimeve ka tejkalluar kufirin e referuar në pikën 1, shkronja b) të këtij neni, Autoriteti pezullon për një periudhë gjashtë mujore përdorimin e atyre përjashtimeve brenda dy ditësh pune në Republikën e Shqipërisë.
4. Me qëllim që të sigurohet një bazë e besueshme për monitorimin e tregtimit që zhvillohet sipas këtyre përjashtimeve dhe për të përcaktuar nëse janë tejkalluar kufijtë e referuar në pikën 1 të këtij neni, operatorët e tregjeve të rregulluara janë të detyruar të kenë në zbatim sistemet dhe procedurat për:
 - a) Të mundësuar identifikimin e të gjitha tregtimeve që janë zhvilluar në tregun e tij të rregulluar sipas këtyre përjashtimeve; dhe
 - b) Të siguruar që në asnjë rrethanë të mos e kalojë përqindjen të tregtimit të lejuar sipas këtyre përjashtimeve, siç referohet në pikën 1, shkronja a) e këtij neni.

Neni 8

Kriteret e transparencës pas tregtimit për tregjet e rregulluara në lidhje me aksionet, dëftesat depozitare, fondet e treguar në bursë (ETF-të), certifikatat dhe instrumentet e tjera financiare të ngjashme

1. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë publik çmimin, vëllimin dhe kohën e transaksioneve të kryera në lidhje me aksionet, dëftesat e depozitarit, fondet e treguar në bursë (ETF-të), certifikatat dhe instrumentet e tjera financiare të ngjashme që tregtohen në atë vend tregtimi.
2. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë publike detajet e të gjitha transaksioneve të tilla sa më afër kohës reale që të jetë e mundur teknikisht.

Neni 9

Detyrimet e transparencës së pas tregtimit në vijim të nenit 10, pika 1 të kësaj Shtojce

1. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë publike detajet e çdo transaksioni duke zbatuar referencën në tabelat 4, 5 dhe 6 të kësaj Shtojce.
2. Kur një raport tregtimesh i publikuar më parë është ndryshuar/anuluar, operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar duhet të bëjnë publik një raport të ri tregtimesh, i cili përmban të gjitha detajet e raportit origjinal dhe flamurin e anulimit të specifikuar në tabelën 6 të kësaj Shtojce.
3. Kur një raporti tregtimesh të publikuar më parë është ndryshuar/anuluar, operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë publike informacionet e mëposhtme:
 - a) Një raport të ri tregtimesh që përmban të gjitha detajet e raportit origjinal të tregtimit dhe flamurin e anulimit të specifikuar në tabelën 6 të kësaj Shtojce;
 - b) Një raport të ri tregtimesh që përmban të gjitha detajet e raportit origjinal me të gjitha detajet e nevojshme të korrigjuara dhe flamurin e ndryshimit të specifikuar në tabelën 6 të kësaj Shtojce.

Neni 10

Publikimi në kohë i transaksioneve sipas nenit 10, pika 1, i kësaj Shtojce

1. Për transaksionet që kryhen në një treg të caktuar të rregulluar, informacioni pas tregtimit bëhet publik në rrethanat e mëposhtme:
 - a) Sa më afër kohës reale teknikisht të mundur dhe në çdo rast brenda një minutë nga transaksioni përkatës kur transaksioni kryhet gjatë orarit zyrtar të tregtimit;
 - b) Përpara hapjes së ditës së ardhshme të tregtimit për atë treg të rregulluar kur transaksioni kryhet jashtë orarit zyrtar të tregtimit të tregut të rregulluar.
2. Informacionet në lidhje me tregtimin e portofolit bëhen publike në lidhje me çdo transaksion, sa më afër kohës reale teknikisht të mundur, duke pasur parasysh nevojën për alokimin e çmimeve për aksione të veçanta, dëftesa depozitari, fond të treguar në bursë (ETF), certifikata dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme.

KREU 2

Transparenca për instrumente që nuk janë instrumente financiare kapitali

Neni 11

Kriteret e transparencës para tregtimit për vendet e tregtimit në lidhje me obligacionet, produktet e strukturuara financiare, kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë dhe derivativët

1. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë publike çmimet aktuale të blerjes dhe shitjes dhe thellësinë e tregut në ato çmime që reklamohen nëpërmjet sistemeve të tyre për obligacionet, produktet e strukturuara financiare, kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë dhe derivativët që tregtohen në një treg të rregulluar dhe urdhrave paketë.

Ky kriter do të zbatohet gjithashtu për treguesit e interesave të zbatueshme. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar e bëjnë atë informacion të disponueshëm për publikun në mënyrë të vazhdueshme gjatë orareve normale të tregtimit.

2. Kriteret e transparencës të referuara në pikën 1 të këtij neni kalibrohen për lloje të ndryshme të sistemeve të tregtimit, duke përfshirë sistemet e librit të urdhrave, të kuotave, hibrideve, të tregtimit me ankand periodik dhe të tregtimit zanor, nëse është e aplikueshme.
3. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar, kur jepet një përjashtim në përputhje me nenin 16, pika 1, shkronja b) e kësaj Shtojce, bëjnë publike të paktën çmimet indikative të blerjes dhe shitjes para tregtimit, të cilat janë afër çmimit të interesave të tregtimit të reklamuar nëpërmjet sistemeve të tyre në obligacione, produkte të strukturuara financiare, kuotave të lejuara të çlirimit të gazrave serrë dhe derivativë që tregtohen në një treg të rregulluar.
4. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë atë informacion të disponueshëm për publikun nëpërmjet mjeteve të përshtatshme elektronike në mënyrë të vazhdueshme gjatë orëve normale të tregtimit.

Këto procedura sigurojnë që informacioni të ofrohet në kushte të arsyeshme tregtare dhe në mënyrë jo diskriminuese.

Neni 12

Përjashtimi për instrumentet që nuk janë instrumente financiare kapitali

1. Autoriteti mund të heqë dorë nga detyrimi që operatorët e tregut të cilët vënë në funksion një treg të rregulluar, të bëjnë publik informacionin e referuar në nenin 15, pika 1 të kësaj Shtojce për:
 - a) Urdhrat që janë në vëllime të mëdha krahasuar me madhësinë normale të tregut dhe urdhrat që mbahen në një sistem të menaxhimit të urdhrave të vendit të tregtimit në pritje të shfaqjes;
 - b) Indikatorë tregues të interesit në sistemet e tregtimit “kërkesë për kuotim” dhe “zanor” që janë mbi një madhësi specifike për instrumentin financiar, që do t'i ekspozonte

ofruesit/mundësuesit e likuiditetit ndaj rrezikut të panevojshëm dhe merr parasysh nëse pjesëmarrësit përkatës të tregut janë investitorë me pakicë ose me shumicë;

- c) Urdhra për qëllimin e ekzekutimit të një kontrate të së ardhmes me një aset ose grup asetesh bazë (“exchange for physical”);
 - d) Urdhrat paketë që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:
 - (i) të paktën një nga përbërësit e tij është një instrument financiar për të cilin nuk ka treg likuid, përveç rastit kur ka një treg likuid për urdhrin paketësi një e tërë;
 - (ii) të paktën një nga komponentët e tij është në shkallë të madhe krahasuar me madhësinë normale të tregut, përveç rasteve kur ka një treg likuid për urdhrin paketë në tërësi;
 - (iii) të gjithë përbërësit e tij janë ekzekutuar në një sistem “kërkesë për kuotim” ose “zanor” dhe janë mbi madhësinë specifike për atë instrument.
2. Autoriteti mund të tërheqë përjashtimin e dhënë sipas pikës 1 të këtij neni, nëse vëren se përjashtimi po përdoret në një mënyrë që devijon nga qëllimi i tij fillestar ose nëse konsideron se po përdoret për të anashkaluar kriteret e përcaktuara në këtë nen.

Neni 13

Kriteret e transparencës pas tregimit për vendet e tregimit në lidhje me obligacionet, produktet e strukturuar financiare, kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë dhe derivativët

- 1. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë publik çmimin, vëllimet dhe kohën e transaksioneve të kryera në lidhje me obligacionet, produktet e strukturuar financiare, kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë dhe derivativët që tregtohen në një vend tregtimi.
- 2. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë publike detajet e të gjitha transaksioneve të tilla sa më afër kohës reale që të jetë e mundur teknikisht.

KREU 3

Detyrimi për të ofruar të dhëna tregtare mbi baza tregtare të veçanta dhe të arsyeshme

Neni 14

Detyrimi për të vënë në dispozicion veçmas të dhënat para tregimit dhe pas tregimit

- 1. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë të disponueshëm për publikun informacionin e publikuar në përputhje me nenet 1, 2, 4 deri në 7 të kësaj Shtojce duke ofruar veçmas të dhënat e transparencës para dhe pas tregimit.
- 2. Operatori i tregut që operon një treg të rregulluar, me kërkesën e tij, bën të disponueshme për publikun informacionet e publikuara në përputhje me nenet 1, 2, 4 deri në 7 të kësaj Shtojce duke ofruar të dhëna para dhe pas tregimit të ndara, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

- a) Natyrën e klasës së asetit:
 - (i) aksionet;
 - (ii) dëftesat e depozitarit, fondet e treguara në bursë (ETF-të), certifikatat dhe instrumentet e tjera financiare të ngjashme të referuara në nenin 1 të kësaj Shtojce;
 - (iii) obligacionet dhe produktet e strukturuar financiare;
 - (iv) kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë;
 - (v) derivativët.
 - b) Vendin/shtetin e emimit për aksionet dhe borxhin sovran;
 - c) Monedhën në të cilën tregtohet instrumenti financiar;
 - d) Ankandet e planifikuara ditore në ndryshim me tregtimin e vazhdueshëm.
3. Operatori i tregut që operon një treg të rregulluar përcakton se cilat kritere plotëson instrumenti financiar ose lloji i të dhënave kur kriteret e ndarjes në pikat 2 ose 3 të këtij neni nuk mund të zbatohen në mënyrë të qartë.
 4. Operatori i tregut që operon një treg të rregulluar zbaton kriteret e referuara në pikat 2 dhe 3 në çdo kombinim sipas kërkesës.
 5. Përveç ofrimit të të dhënave në përputhje me pikat 2 dhe 3, operatori i tregut që operon një treg të rregulluar mund të ofrojë paketa të dhënash.

Neni 15

Detyrimi për të vënë në dispozicion të dhënat para dhe pas tregtimit mbi një bazë të arsyeshme tregtare

1. Operatorët e tregut që vënë në funksion një treg të rregulluar bëjnë të disponueshme për publikun informacionet e publikuara në përputhje me nenet 1, 2, 4 deri në 7 mbi baza të arsyeshme tregtare dhe sigurojnë akses jo diskriminues në informacione.
2. Këto informacione vihen në dispozicion pa pagesë 15 minuta pas publikimit.

Kreu 4

Raportimi i transaksionit

Neni 16

Detyrimi për të mbajtur rekorde/të dhëna

Operatori i tregut që vë në funksion një treg të rregulluar vendos në dispozicion të Autoritetit, për të paktën pesë vjet, të dhënat përkatëse në lidhje me të gjithë urdhrat në instrumente financiare që reklamohen nëpërmjet sistemeve të tyre. Rekordet/të dhënat duhet të përmbajnë të dhënat përkatëse që përbëjnë karakteristikat e urdhrat, duke përfshirë ato që

lidhin një urdhër me transaksionin/et e ekzekutuar që rrjedhin nga ai urdhër dhe detajet e të cilave raportohen në përputhje me këtë Shtojcë.

Neni 17 **Detyrimi për të raportuar transaksionet**

1. Operatorët e tregut që operojnë një treg të rregulluar duhet t'i raportojnë Autoritetit detajet e plota dhe të sakta të transaksioneve të kryera nëpërmjet sistemeve të tyre sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se mbyllja e ditës së punës pasardhëse.
2. Raportet, në veçanti, duhet të përfshijnë detaje të llojit dhe numrave të instrumenteve financiare të blera ose të shitura, sasinë, datat dhe kohën e ekzekutimit, çmimet e transaksionit, një përcaktim për të identifikuar klientët në emër të të cilëve shoqëria komisionere e ka ekzekutuar atë transaksion.

Neni 18 **Detyrimi për të ofruar të dhëna referuese të instrumentit financiar**

Në lidhje me instrumentet financiare të pranuar për tregtim në tregje të rregulluara, i ofrojnë Autoritetit të dhëna referuese identifikuese për qëllime të raportimit të transaksioneve sipas kësaj Shtojce.

Tabela 1
Përshkrimi i llojit të sistemeve të tregtimit dhe informacionet përkatëse që do të bëhen publike në përputhje me nenin 1 të kësaj Shtojce

Lloji i sistemit të tregtimit	Përshkrimi i sistemit të tregtimit	Informacione që do të bëhen publike
Sistemi i tregtimit të librit të urdhrave të ankandëve të vazhdueshme	Një sistem që me anë të një libri urdhrash dhe një algoritmi tregtimi që funksionon pa ndërhyrjen njerëzore, përshtat urdhrat e shitjes me urdhrat e blerjes në bazë të çmimit më të mirë të disponueshëm në mënyrë të vazhdueshme.	Numri i përgjithshëm i urdhrave dhe aksioneve, dëftesave të depozitarit, fondeve të treguara në bursë (ETF-ve), certifikatave dhe instrumenteve të tjera financiare të ngjashme që ato përfaqësojnë në çdo nivel çmimi për të paktën pesë nivelet më të mira të çmimeve të blerjes dhe shitjes
Sistemi i tregtimit "quote-driven"	Një sistem ku transaksionet realizohen në bazë të kuotave të qëndrueshme që vihen në dispozicion vazhdimisht për pjesëmarrësit, gjë që kërkon nga krijuesit e tregut të mbajnë kuotat në një madhësi që balancon nevojat e anëtarëve dhe pjesëmarrësve	Çmimi më i mirë i blerjes dhe shitjes sipas çmimit të çdo krijuesi të tregut në aksione, dëftesa depozitari, fonde të

	<p>për të vepruar me një madhësi komerciale dhe rrezikun ndaj të cilit ekspozohet krijuesi i tregut.</p>	<p>treguara në bursë (ETF), certifikata dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme që tregtohen në sistemin e tregtimit, së bashku me vëllimet që i bashkëngjiten këtyre çmimeve.</p> <p>Kuotat e bëra publike do të jenë ato që përfaqësojnë angazhime të detyrueshme për blerjen dhe shitjen e instrumenteve financiare dhe që tregojnë çmimin dhe volumin e instrumenteve financiare në të cilat tregtarët e regjistruar janë të përgatitur të blejnë ose të shesin. Megjithatë, në kushte të jashtëzakonshme tregu, çmimet indikative ose të njëanshme mund të lejohen për një kohë të kufizuar.</p>
<p>Sistemi i tregtimit me ankand periodik</p>	<p>Një sistem që përputhet me urdhrat në bazë të një ankandi periodik dhe një algoritmi tregtimi që funksionon pa ndërhyrjen njerëzore.</p>	<p>Çmimi me të cilin sistemi i tregtimit në ankand do të përmbushte më së miri algoritmin e tij të tregtimit në lidhje me aksionet, dëftesat e depozitarit, fondet e treguara në bursë (ETF-të), certifikatat dhe instrumentet e tjera financiare të ngjashme që tregtohen në sistemin e tregtimit dhe vëllimi që do të ishte potencialisht i ekzekutueshëm në atë çmim nga pjesëmarrësit në atë sistem.</p>
<p>Sistemi i tregtimit “Kërkesë për kuotim”</p>	<p>Një sistem tregtimi ku ofrohet një kuotim ose disa kuotime në përgjigje të një kërkesë për kuotim të paraqitur nga një ose më shumë anëtarë ose pjesëmarrës. Kuota është e ekzekutueshme ekskluzivisht nga anëtari ose pjesëmarrësi kërkuar. Anëtari ose pjesëmarrësi kërkuar mund të kryejë një transaksion duke pranuar kuotimin/ kuotimet e ofruara sipas kërkesës.</p>	<p>Kuotimet dhe vëllimet e bashkangjitura nga çdo anëtar ose pjesëmarrës, të cilat, nëse pranohen, do të çonin në një transaksion sipas rregullave të sistemit. Të gjitha kuotimet e dorëzuara në përgjigje të një “kërkesë për kuotë” mund të publikohen në të njëjtën kohë,</p>

		por jo më vonë se koha kur ato bëhen të ekzekutueshme.
Çdo sistem tjetër tregtimi	Çdo lloj tjetër sistemi tregtimi, duke përfshirë një sistem “hibrid” që përfshihet në dy ose më shumë nga llojet e sistemeve të tregtimit të referuara në këtë tabelë.	Informacione të përshtatshme në lidhje me nivelin e urdhrave ose kuotave dhe të interesit të tregtimit në lidhje me aksionet, dëftesat e depozitarit, fondet e treguara në bursë (ETF-të), certifikatat dhe instrumentet e tjera financiare të ngjashme që tregtohen në sistemin e tregtimit; në veçanti, pesë nivelet më të mira të çmimeve të blerjes dhe shitjes dhe/ose kuotat e dyanshme të secilit krijues të tregut në atë instrument, nëse karakteristikat e mekanizmit të zbulimit të çmimit e lejojnë këtë.

Tabela 2

Urdhrat në shkallë të madhe krahasuar me madhësinë normale të tregut për aksionet dhe dëftesat e depozitarit

Qarkullimi mesatar ditor (QMD) në Lekë	QMD < 5,700,000	5,700,000 ≤ QMD < 11,400,000	11,400,000 ≤ QMD < 57,000,000	57,000,000 ≤ QMD < 114,000,000	114,000,000 ≤ QMD < 570,000,000	570,000,000 ≤ QMD < 2,850 milion	2,850 milion ≤ QMD < 5,700 milion	5,700 milion ≤ QMD < 11,400 milion	QMD ≥ 11,400 milion
Madhësia minimale e urdhrave që kualifikohe n si në shkallë të madhe krahasuar me madhësinë normale të tregut në Lekë	1,700,000	3,400,000	6,800,000	11,400,000	22,800,000	34,200,000	45,600,000	57,000,000	74,100,000

Tabela 3**Urdhrat në shkallë të madhe krahasuar me certifikatat e madhësisë normale të tregut dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme**

Qarkullimi mesatar ditor (QMD) në Lekë	QMD < 5,700,000	QMD ≥ 5,700,000
Madhësia minimale e urdhrave që kualifikohen si në shkallë të madhe krahasuar me madhësinë normale të tregut në Lekë	1,700,000	3,400,000

Tabela 4
Lista e detajeve për qëllimin e transparencës pas tregtimit

Detajet	Përshkrimi dhe detajet që do të publikohen	Lloji i ekzekutimit ose vendit i publikimit
Data dhe ora e tregtimit	Data dhe ora kur është ekzekutuar transaksioni	Tregu i rregulluar
Kodi i identifikimit të instrumentit	Kodi i përdorur për të identifikuar instrumentin financiar	Tregu i rregulluar
Çmimi	Çmimi i tregtuar i transaksionit duke përjashtuar, aty ku është e aplikueshme, komisionin dhe interesin e grumbulluar	Tregu i rregulluar
Monedha e çmimit	Monedha në të cilën është shprehur çmimi (e aplikueshme nëse çmimi shprehet si vlerë monetare)	Tregu i rregulluar
Sasia	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i njësive të instrumenteve financiare (LOT) • Vlera nominale ose monetare e instrumentit financiar • Informacioni i raportuar në këtë fushë duhet të jetë në përputhje me vlerat e dhëna në fushën “Çmimi” 	Tregu i rregulluar
Vendi i ekzekutimit	Identifikimi i tregut të rregulluar ku është ekzekutuar transaksioni.	Tregu i rregulluar

Data dhe ora e publikimit	Data dhe ora kur transaksioni është publikuar nga tregu i rregulluar ose “APA”.	Tregu i rregulluar
Vendi i publikimit	Kodi i përdorur për të identifikuar vendin e tregtimit.	Tregu i rregulluar
Kodi i identifikimit të transaksionit	Kodi alfanumerik i caktuar nga tregjet e rregulluara.	Tregu i rregulluar

Tabela 5
Lista e flamujve për qëllimin e transparencës pas tregtimit

Flamuri	Emri	Lloji i ekzekutimit ose vendit të publikimit	Përshkrimi
“BENC”	Flamuri i transaksioneve referencë	Tregu i rregulluar	Transaksionet e kryera në lidhje me një çmim që llogaritet në raste të shumta kohore sipas një treguesi referencë, si çmimi mesatar i ponderuar me vëllim ose çmimi mesatar i ponderuar me kohë.
“NPFT”	Flamuri i transaksioneve që nuk krijojnë çmime	Tregu i rregulluar	Transaksionet ku shkëmbimi i instrumenteve financiare përcaktohet nga faktorë të ndryshëm nga vlerësimi aktual i tregut të instrumentit financiar siç renditet në nenin 13.
“LRGS”	Flamuri i transaksioneve në shkallë të gjerë pas tregtimit	Tregu i rregulluar	Transaksionet që janë në shkallë të madhe krahasuar me madhësinë normale të tregut për të cilat lejohet publikimi i shtyrë sipas nenit 15.
“RFPT”	Flamuri i transaksionit të çmimit të referencës	Tregu i rregulluar	Transaksionet që kryhen sipas sistemeve që funksionojnë në përputhje me nenin 2, pika 1, shkronja a), të kësaj Shtojce.
“NLIQ”	Flamuri i transaksionit të negociuar në instrumente financiare likuide	Tregu i rregulluar	Transaksionet e kryera në përputhje me nenin 2 pika 1, shkronja b) nën-pika (i) të kësaj Shtojce

“OILQ”	Flamuri i transaksionit të negociuar në instrumente financiare jo-likuide	Tregu i rregulluar	Transaksionet e kryera në përputhje me nenin 2 pika 1, shkonja b) nënpika (ii) të kësaj Shtojce
“PRIC”	Transaksioni i negociuar i nënshtrohet kushteve të ndryshme nga flamuri aktual i çmimit të tregut	Tregu i rregulluar	Transaksionet e kryera në përputhje me nenin pika 1, shkonja b) nënpika (iii) të kësaj Shtojce.
“CANC”	Flamuri i anulimit	Tregu i rregulluar	Kur anulohet një transaksion i publikuar më parë.
“AMND”	Flamuri i amendamentit	Tregu i rregulluar	Kur një transaksion i publikuar më parë është ndryshuar.

SHTOJCA IV
PASTRIMI I PARAVE

Nr. i Çështjes	Përshkrimi i çështjes	Numri i referencës së dokumentit nëse dokumentet dorëzohen për shpjegim	Titulli i dokumentit, nëse dokumentet dorëzohen për shpjegim	Shpjegimi i çështjes me shkrim

SHTOJCA V
Blerja dhe shitja/likuidimi i titujve

Tituj	Titujt të blerë	Numri i titujve të blerë	Numri i titujve të mbajtura
[ISIN]			
[ISIN]			
[ISIN]			

Tituj	Tituj të shitur/likuiduar	Numri i titujve të blerë	Numri i titujve të mbajtura
[ISIN]			